ADEM ZAPLLUZHA

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

ADEM ZAPLLUZHA

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

Redaktor:
Baki Ymeri

Recensent:
Baki Ymeri

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

Redaktor:
Baki Ymeri

Recensent:
Baki Ymeri

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

ADEM ZAPLLUZHA

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

ADEM ZAPLLUZHA

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2019

POETI ËSHTË MBRET NË ATDHEUN E VET

Poezia është boshti kurrizor që e ndërlidh qiellin me tokën. Ajo është një Zonjë e lartë që bashkon zemra dhe përjetime. Poeti dhe poeteshat kultivojnë dhe mbëltojnë harmoni në botë. Poezia është nëna e dashurive të shtrenjta. Poezia dhe muzika janë dhurata hyjnore të qetësisë së shpirtit, jehona e një ndjeshmërie të brishtë, prodhimi më i zgjedhur i meditimit ku lartësohen ndjenjat. Poeti Adem Zaplluzha është një anije fluturuese që vërtitet përreth botës së fjalëve. Ai është krye veterani i veteranëve të Kosovës poetike që shkruan për engjëjt e Dardanisë dhe për zogjtë e kohës që flatrojnë mbi karrocën e mbushur me fjalë, lule dhe flutura. Poeti dhe poezia shëmbëllejnë me një kandil shkëlqimtar të cilin nuk e tremb asnjë errësirë. Poeti është një verigë që e ndërlidh botën e sotme me botën e ardhmërisë. Një pemë e mbëltuar në bregun e Lumit të Bukurisë. Poeti është një bilbil që kërcen nga njëra në degën tjetër të fjalëve, duke krijuar melodi që e mbushin trupin me butësi dhe delikatesë. Numri i poetëve të botës që shkruajnë për ëndërrime është i

ADEM ZAPLLUZHA

POETI ËSHTË MBRET NË ATDHEUN E VET

Poezia është boshti kurrizor që e ndërlidh qiellin me tokën. Ajo është një Zonjë e lartë që bashkon zemra dhe përjetime. Poeti dhe poeteshat kultivojnë dhe mbëltojnë harmoni në botë. Poezia është nëna e dashurive të shtrenjta. Poezia dhe muzika janë dhurata hyjnore të qetësisë së shpirtit, jehona e një ndjeshmërie të brishtë, prodhimi më i zgjedhur i meditimit ku lartësohen ndjenjat. Poeti Adem Zaplluzha është një anije fluturuese që vërtitet përreth botës së fjalëve. Ai është krye veterani i veteranëve të Kosovës poetike që shkruan për engjëjt e Dardanisë dhe për zogjtë e kohës që flatrojnë mbi karrocën e mbushur me fjalë, lule dhe flutura. Poeti dhe poezia shëmbëllejnë me një kandil shkëlqimtar të cilin nuk e tremb asnjë errësirë. Poeti është një verigë që e ndërlidh botën e sotme me botën e ardhmërisë. Një pemë e mbëltuar në bregun e Lumit të Bukurisë. Poeti është një bilbil që kërcen nga njëra në degën tjetër të fjalëve, duke krijuar melodi që e mbushin trupin me butësi dhe delikatesë. Numri i poetëve të botës që shkruajnë për ëndërrime është i

4

panumërt. Njëri ndër ta është edhe baca Adem. Poezia e tij është jeta e shpirtit tonë, një gurrë e ëmbël që ua shuan etjen shpirtrave të etshëm për dashuri dhe kulturë. Poezia është një pemë me fryte të ëmbla për shijen e shpirtrave të uritur: “Nuk thonë kot/ Se historia përsëritet/ Si në ëndërr dëgjova piskamat/ E trishtuara të perëndive/ Ishin çmendur hyjnitë e Olimpit/ Nga urrejtja e dehur. (Si në ëndërr dëgjova piskamat) Novalis konsideron se „poezia përbën një pjesë të teknikës filozofike”. Ajo është forma më e lartë e manifestimit shpirtëror. Poezia është e bija e mahnitjes, ndërsa poeti shqiponjë që flatron mbi Luginën e Lumturisë. Ai është valë e trazuar e lumenjve të dashurisë. Në vargjet e Adem Zaplluzhës shprehen mendimet, idetë dhe ndjenjat në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet unit poetik. Në kuadrin e kësaj gjinie letrare zotëron vizioni dhe transfigurimi artistik, autori duke apeluar te teknikat e aluzionit, duke krijuar një univers me forcë të madhe të sugjestionit që i drejtohet lexuesit. Kështu që, nga ky pikëshikim, poeti shpreh sentimentalizmin nëpërmjet figurave të stilit dhe të simboleve. Lirika e tij ka vlera të pakontestueshme universale: „Ku ishin

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

panumërt. Njëri ndër ta është edhe baca Adem. Poezia e tij është jeta e shpirtit tonë, një gurrë e ëmbël që ua shuan etjen shpirtrave të etshëm për dashuri dhe kulturë. Poezia është një pemë me fryte të ëmbla për shijen e shpirtrave të uritur: “Nuk thonë kot/ Se historia përsëritet/ Si në ëndërr dëgjova piskamat/ E trishtuara të perëndive/ Ishin çmendur hyjnitë e Olimpit/ Nga urrejtja e dehur. (Si në ëndërr dëgjova piskamat) Novalis konsideron se „poezia përbën një pjesë të teknikës filozofike”. Ajo është forma më e lartë e manifestimit shpirtëror. Poezia është e bija e mahnitjes, ndërsa poeti shqiponjë që flatron mbi Luginën e Lumturisë. Ai është valë e trazuar e lumenjve të dashurisë. Në vargjet e Adem Zaplluzhës shprehen mendimet, idetë dhe ndjenjat në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet unit poetik. Në kuadrin e kësaj gjinie letrare zotëron vizioni dhe transfigurimi artistik, autori duke apeluar te teknikat e aluzionit, duke krijuar një univers me forcë të madhe të sugjestionit që i drejtohet lexuesit. Kështu që, nga ky pikëshikim, poeti shpreh sentimentalizmin nëpërmjet figurave të stilit dhe të simboleve. Lirika e tij ka vlera të pakontestueshme universale: „Ku ishin

5

perënditë/ Kur u krijua toka/.../ Thonë se edhe atë ditë/ Nuk ditën të pushojnë shirat/ Tok me të reshurat/ Binin edhe thashethemet/ Ndoshta nga frika u krijuan Perënditë/ /Kurrë më nuk u ndalën fjalët/ Një flakadan që ndizej në Olimp/ Ndizej mes kolonadave/ Ku piqeshin/ Zogjtë e ngrirë të qiellit (Ndoshta nga frika u krijuan Perënditë) Lasgush Poradeci, Murat Isaku dhe Azem Shkreli kanë shprehur mendimet më të bukura për poetin dhe poezinë. Eqrem Çabej thekson se „Lasgush Poradeci hapi portën e një jetë të re në poezinë shqiptare." Asdreni sipas Çabejt, „e pasuron thesarin e gjuhës me xhevahire të çmueshme, me fjalë e mënyra shprehjesh të reja, delikate e stërmagjike." Baca Adem duke respektuar porositë e Azem Shkrelit që ishte mjeshtër i vargut dhe fjalës: „Mos u bëj poet nëse s'mund të lindësh/ me secilin varg, të lindësh me secilën fjalë.// Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh/ për secilën varg, të vdesësh për secilën fjalë. Sipas Bujar Tafës, „Poeti është i zgjedhuri i Zotit." Poezia sipas Emineskut është „trëndafili që rritet në saksinë e artë të shpirtit të bukur." Sipas Adem Zaplluzhës: „Njerëzit gabojnë/ Kur flasin për vdekjen e drurëve/ Ose të dashurisë/ Në jetë nuk ka vdekje/ Përpos

ADEM ZAPLLUZHA

perënditë/ Kur u krijua toka/.../ Thonë se edhe atë ditë/ Nuk ditën të pushojnë shirat/ Tok me të reshurat/ Binin edhe thashethemet/ Ndoshta nga frika u krijuan Perënditë/ /Kurrë më nuk u ndalën fjalët/ Një flakadan që ndizej në Olimp/ Ndizej mes kolonadave/ Ku piqeshin/ Zogjtë e ngrirë të qiellit (Ndoshta nga frika u krijuan Perënditë) Lasgush Poradeci, Murat Isaku dhe Azem Shkreli kanë shprehur mendimet më të bukura për poetin dhe poezinë. Eqrem Çabej thekson se „Lasgush Poradeci hapi portën e një jetë të re në poezinë shqiptare." Asdreni sipas Çabejt, „e pasuron thesarin e gjuhës me xhevahire të çmueshme, me fjalë e mënyra shprehjesh të reja, delikate e stërmagjike." Baca Adem duke respektuar porositë e Azem Shkrelit që ishte mjeshtër i vargut dhe fjalës: „Mos u bëj poet nëse s'mund të lindësh/ me secilin varg, të lindësh me secilën fjalë.// Mos u bëj poet nëse s'mund të vdesësh/ për secilën varg, të vdesësh për secilën fjalë. Sipas Bujar Tafës, „Poeti është i zgjedhuri i Zotit." Poezia sipas Emineskut është „trëndafili që rritet në saksinë e artë të shpirtit të bukur." Sipas Adem Zaplluzhës: „Njerëzit gabojnë/ Kur flasin për vdekjen e drurëve/ Ose të dashurisë/ Në jetë nuk ka vdekje/ Përpos

6

ndërrimit të adresës.” Dhe më tej: „Unë disa herë në jetë/ I ndërrova me qindra adresa/ Por ende kam mbetur/ Një poet endacak/ Ose një rrugaç pa portofol në xhep” (Një mister i panjohur)Sipas Jeton Kelmendit, „poezia si kategori e së bukurës ka dimensionet e veta të cilat paraqiten tek lexuesi, prandaj poetët që nga kohët e lashta janë konsideruar si elita, apo njerëz të rangut të lartë.” Sejdi Berisha thekson se „Poetët, të cilët pjesë të jetës, të gjakut dhe të dashurisë e të etjes e kanë luftën për liri, ata vargun e kanë këngë madhështie, me të cilën, sado mirë që e këndojnë, ata prapëseprapë mbeten të etur për të thënë e për të rrëfyer edhe diçka, dhe atë, duke filluar nga vetvetja e deri tek rrugëtimi nëpër zjarr që ka lënë gjurmë për të thënë shumë, për t’u mburrur e për t’u kritikuar. Kjo ngase, toka e lagur me gjak ka shumë këngë, rrëfime e ngjarje të pathëna, mbase pra edhe të pa kënduara.” Imagjinata e Adem Zaplluzhës është e pasur, siç është e pasur edhe lirika e tij me vlera universale: „Dikur vonë tepër vonë kuptova/ Se Odiseja/ Kurrë nuk kishte hipur në anijen/ As që kishin njohur marinarët/**...**/Dukur vonë kur u kthye në atdhe/ Nuk e priste Penelopa/ Sepse s’ishte martuar asnjëherë me të/ Ishte një

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ndërrimit të adresës.” Dhe më tej: „Unë disa herë në jetë/ I ndërrova me qindra adresa/ Por ende kam mbetur/ Një poet endacak/ Ose një rrugaç pa portofol në xhep” (Një mister i panjohur)Sipas Jeton Kelmendit, „poezia si kategori e së bukurës ka dimensionet e veta të cilat paraqiten tek lexuesi, prandaj poetët që nga kohët e lashta janë konsideruar si elita, apo njerëz të rangut të lartë.” Sejdi Berisha thekson se „Poetët, të cilët pjesë të jetës, të gjakut dhe të dashurisë e të etjes e kanë luftën për liri, ata vargun e kanë këngë madhështie, me të cilën, sado mirë që e këndojnë, ata prapëseprapë mbeten të etur për të thënë e për të rrëfyer edhe diçka, dhe atë, duke filluar nga vetvetja e deri tek rrugëtimi nëpër zjarr që ka lënë gjurmë për të thënë shumë, për t’u mburrur e për t’u kritikuar. Kjo ngase, toka e lagur me gjak ka shumë këngë, rrëfime e ngjarje të pathëna, mbase pra edhe të pa kënduara.” Imagjinata e Adem Zaplluzhës është e pasur, siç është e pasur edhe lirika e tij me vlera universale: „Dikur vonë tepër vonë kuptova/ Se Odiseja/ Kurrë nuk kishte hipur në anijen/ As që kishin njohur marinarët/**...**/Dukur vonë kur u kthye në atdhe/ Nuk e priste Penelopa/ Sepse s’ishte martuar asnjëherë me të/ Ishte një

7

njeri që i frikohej deteve**”** (Nuk e priste Penelopa). Jo vetëm kjo, por edhe një gamë vjershash tjera të bacës Adem reflektojnë një botë ndjenjash dhe mendimesh të vrullshme. Poeti shëmbëllen me zogun që flatron mbi valët e detit duke kaluar tejmatanë përjetësisë së kohës. Kush e ndjen dhe kupton poezinë e vërtetë, as që ka nevojë t’i lexojë Librat e Shenjtë të botës, ngase poeti në mënyrë të pavetëdijshme i interpreton si askush tjetër Mësimet e Shenjta. Vëllimi “Kur kthehen zogjtë e shiut” është i strukturuar në tre cikle. Në kuadrin e ciklit të tretë (Nga malet zbritën zërat e egra), kemi fatin të ballafaqohemi me poezitë: Brenda meje një gjendje asnjanëse. Fryj moj erë. Kanë shlyer njëherë e përgjithmonë, Imiton me disa gjeste delikate, Kur gjethet shkërmoqen, Disa lloje shtambash prej argjile, Secili paraqitej më i mirë se Krishti, Ky diell i akullt Homerian, Mos harro të lutem, Me gjuhën e metaltë të njeriut, Si një akrobat i përsosur, Deshën të mrekullohen. Çfarë të bëjë me itineraret, Si varri i katragjyshit tim, Nga malet zbritnin zërat e egra, Sa shumë na ndihmuan atë ditë zogjtë e shiut, etj. Adem Zaplluzha shëmbëllen me një kandil shkëlqimtar të cilin

ADEM ZAPLLUZHA

njeri që i frikohej deteve**”** (Nuk e priste Penelopa). Jo vetëm kjo, por edhe një gamë vjershash tjera të bacës Adem reflektojnë një botë ndjenjash dhe mendimesh të vrullshme. Poeti shëmbëllen me zogun që flatron mbi valët e detit duke kaluar tejmatanë përjetësisë së kohës. Kush e ndjen dhe kupton poezinë e vërtetë, as që ka nevojë t’i lexojë Librat e Shenjtë të botës, ngase poeti në mënyrë të pavetëdijshme i interpreton si askush tjetër Mësimet e Shenjta. Vëllimi “Kur kthehen zogjtë e shiut” është i strukturuar në tre cikle. Në kuadrin e ciklit të tretë (Nga malet zbritën zërat e egra), kemi fatin të ballafaqohemi me poezitë: Brenda meje një gjendje asnjanëse. Fryj moj erë. Kanë shlyer njëherë e përgjithmonë, Imiton me disa gjeste delikate, Kur gjethet shkërmoqen, Disa lloje shtambash prej argjile, Secili paraqitej më i mirë se Krishti, Ky diell i akullt Homerian, Mos harro të lutem, Me gjuhën e metaltë të njeriut, Si një akrobat i përsosur, Deshën të mrekullohen. Çfarë të bëjë me itineraret, Si varri i katragjyshit tim, Nga malet zbritnin zërat e egra, Sa shumë na ndihmuan atë ditë zogjtë e shiut, etj. Adem Zaplluzha shëmbëllen me një kandil shkëlqimtar të cilin

8

nuk e tremb asnjë errësirë. Fjalët e tij duken si do nuse të bukura që i veshin fustanet e mëndafshta që fëshfërisnin . Sinqeriteti i tij del në pah me njërën nga poezitë më të bukura të kësaj vepre: “Me pensionin e fundit pata fat”. Poezia është kurorëzimi i realitetit me imagjinatën dhe idealin në shpirtin e poetit. Kjo vlen vetëm për ato momente kur poeti është poet. Fjalët zgjohen nga gjumi kur poetët ëndërrojnë. Bota e fjalëve është bota e ëndrrave. Ëndërrimet janë një manifestim i dëshirave tona të fshehura në shpirtin tonë. Disa nga to janë aq reale, saqë kur zgjohesh, duket se një pjesë e shpirtit tënd ka mbetur edhe më tej në ëndërr.

(Bukuresht, 24 Korrik 2018)
Baki Ymeri

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

nuk e tremb asnjë errësirë. Fjalët e tij duken si do nuse të bukura që i veshin fustanet e mëndafshta që fëshfërisnin . Sinqeriteti i tij del në pah me njërën nga poezitë më të bukura të kësaj vepre: “Me pensionin e fundit pata fat”. Poezia është kurorëzimi i realitetit me imagjinatën dhe idealin në shpirtin e poetit. Kjo vlen vetëm për ato momente kur poeti është poet. Fjalët zgjohen nga gjumi kur poetët ëndërrojnë. Bota e fjalëve është bota e ëndrrave. Ëndërrimet janë një manifestim i dëshirave tona të fshehura në shpirtin tonë. Disa nga to janë aq reale, saqë kur zgjohesh, duket se një pjesë e shpirtit tënd ka mbetur edhe më tej në ëndërr.

(Bukuresht, 24 Korrik 2018)
Baki Ymeri

9

ADEM ZAPLLUZHA

10

Cikli i parë
U dëgjuan britmat e shiut

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Cikli i parë
U dëgjuan britmat e shiut

11

ADEM ZAPLLUZHA

12

SI NË ËNDËRR DËGJOVA PISKAMAT

Për të shtatën herë sot sërish ra shi
Si nga baladat e lashta
Anijet Homerike
Dolën në brigjet e Jonit
Dolën
Dhe i pritën me ushta e shpata
Cirqet e egra

Nuk thonë kot
Se historia përsëritet
Si në ëndërr dëgjova piskamat
E trishtuara të perëndive
Ishin çmendur Zotat e Olimpit
Nga dehja e urrejtjes
Nuk i ndalnin vigmat e pandërprera

Dhe sërish shiu nuk pushon
Po bie si gur dhembjeje
Mbi kokat
E dykrenorëve
Nuk pat Zot as perëndi
I cili mund t'i ndalte
Mallkimet e shekujve mbi shpirtrat tona

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

SI NË ËNDËRR DËGJOVA PISKAMAT

Për të shtatën herë sot sërish ra shi
Si nga baladat e lashta
Anijet Homerike
Dolën në brigjet e Jonit
Dolën
Dhe i pritën me ushta e shpata
Cirqet e egra

Nuk thonë kot
Se historia përsëritet
Si në ëndërr dëgjova piskamat
E trishtuara të perëndive
Ishin çmendur Zotat e Olimpit
Nga dehja e urrejtjes
Nuk i ndalnin vigmat e pandërprera

Dhe sërish shiu nuk pushon
Po bie si gur dhembjeje
Mbi kokat
E dykrenorëve
Nuk pat Zot as perëndi
I cili mund t'i ndalte
Mallkimet e shekujve mbi shpirtrat tona

13

NDOSHTA NGA FRIKA U KRIJUAN PERËNDITË

Ku ishin perënditë
Kur u krijua toka
Mos vallë
Erdhën ditën e dhjetë
Kur njeriu u ngjizë me smirën

Thonë se atë ditë
Nuk ditën të pushojnë shirat
Tok me të reshurat
Binin edhe thashethemet
Ndoshta nga frika u krijuan perënditë

Kurrë më nuk u ndalën fjalët
Një flakadan që ndizej në Olimp
Ndizej mes kolonadave
Ku piqeshin
Zogjtë e ngrirë të qiellit

Askush nuk di
Athua vallë ishte dimër
Ose pranverë e hershme
Por gjithsesi ishte një stinë e egër
Sa që për një fjalë goje zhdukej njeriu

ADEM ZAPLLUZHA

NDOSHTA NGA FRIKA U KRIJUAN PERËNDITË

Ku ishin perënditë
Kur u krijua toka
Mos vallë
Erdhën ditën e dhjetë
Kur njeriu u ngjizë me smirën

Thonë se atë ditë
Nuk ditën të pushojnë shirat
Tok me të reshurat
Binin edhe thashethemet
Ndoshta nga frika u krijuan perënditë

Kurrë më nuk u ndalën fjalët
Një flakadan që ndizej në Olimp
Ndizej mes kolonadave
Ku piqeshin
Zogjtë e ngrirë të qiellit

Askush nuk di
Athua vallë ishte dimër
Ose pranverë e hershme
Por gjithsesi ishte një stinë e egër
Sa që për një fjalë goje zhdukej njeriu

14

NJË MISTER I PANJOHUR

Njerëzit gabojnë
Kur flasin për vdekjen e drurëve
Ose të dashurisë
Në jetë nuk ka vdekje
Përpos ndërrimit të adresës

Unë disa herë në jetë
I ndërrova me qindra adresa
Por ende kam mbetur
Një poet endacak
Ose një njeri pa portofol në xhep

Përherë shikoj se si ndryshojnë
Njerëzit
Ndryshojnë aq shumë sa që
Nga kurrizi i tyre si rrëshira
Pikon qiriu i harxhuar

Një mister i panjohur
Fshihet mbi gungën e devesë
Sa herë që e mundon etja
Me një gjemb kaktusi
Shuan dhembjen e rërës dhe të shkretëtirës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NJË MISTER I PANJOHUR

Njerëzit gabojnë
Kur flasin për vdekjen e drurëve
Ose të dashurisë
Në jetë nuk ka vdekje
Përpos ndërrimit të adresës

Unë disa herë në jetë
I ndërrova me qindra adresa
Por ende kam mbetur
Një poet endacak
Ose një njeri pa portofol në xhep

Përherë shikoj se si ndryshojnë
Njerëzit
Ndryshojnë aq shumë sa që
Nga kurrizi i tyre si rrëshira
Pikon qiriu i harxhuar

Një mister i panjohur
Fshihet mbi gungën e devesë
Sa herë që e mundon etja
Me një gjemb kaktusi
Shuan dhembjen e rërës dhe të shkretëtirës

15

ME NJË BASTUN TË PLEQËRISË

Njeriu ende nuk mësoi
Se ku fshihet dhembja
Dhe ku fle dashuria
Por gjithsesi
Dhembjen dhe dashurinë
E vendos në një shtambë prej deltine

Sa herë që i kujtohet adoleshenca
Me një kashtë thekre
Si mushkonja që e thith gjakun
Njeriu nga shtamba
Thith lotin e dhembjes
Po ashtu edhe të dashurisë

Kur i vjen kohe e elefantëve
Ai di se ku janë varret
Me një bastun të pleqërisë
Si nëpër dyer
Troket në kalldrëmet e qytetit
Troket për t'i zgjuar etërit e fjetur

ADEM ZAPLLUZHA

ME NJË BASTUN TË PLEQËRISË

Njeriu ende nuk mësoi
Se ku fshihet dhembja
Dhe ku fle dashuria
Por gjithsesi
Dhembjen dhe dashurinë
E vendos në një shtambë prej deltine

Sa herë që i kujtohet adoleshenca
Me një kashtë thekre
Si mushkonja që e thith gjakun
Njeriu nga shtamba
Thith lotin e dhembjes
Po ashtu edhe të dashurisë

Kur i vjen kohe e elefantëve
Ai di se ku janë varret
Me një bastun të pleqërisë
Si nëpër dyer
Troket në kalldrëmet e qytetit
Troket për t'i zgjuar etërit e fjetur

16

KUR DILNIM NË DUEL PËRBALLË DRAGONJVE

Disi si në ndonjë ëndërr
Më kujtohen stinët e drurëve
Më kujtohen kah i numëronim
Gjembat e trëndafilave
Atëherë ishim të dashuruar

Nga asnjë perëndi nuk kishim frikë
Mbase as që ekzistonte
Frika në fjalorin tonë
U shëmbëllenim rrufeve
Kur dilnin në duel përballë dragonjve

Ishte një kohë e egër
Thonë se një pushkë shitej
Nga shtatë herë në ditë
Në daç ta shpëtosh lëkurën
Shite lopën për një pushkë pa gjilpërë

Nuk lëmë gjë pa shitur
Derisa u zgjua djemuria
Nga një letargji vdekjeprurëse
U zgjua dhe si dragonjtë e përrallave
I doli përballë të keqes që na ngufate

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KUR DILNIM NË DUEL PËRBALLË DRAGONJVE

Disi si në ndonjë ëndërr
Më kujtohen stinët e drurëve
Më kujtohen kah i numëronim
Gjembat e trëndafilave
Atëherë ishim të dashuruar

Nga asnjë perëndi nuk kishim frikë
Mbase as që ekzistonte
Frika në fjalorin tonë
U shëmbëllenim rrufeve
Kur dilnin në duel përballë dragonjve

Ishte një kohë e egër
Thonë se një pushkë shitej
Nga shtatë herë në ditë
Në daç ta shpëtosh lëkurën
Shite lopën për një pushkë pa gjilpërë

Nuk lëmë gjë pa shitur
Derisa u zgjua djemuria
Nga një letargji vdekjeprurëse
U zgjua dhe si dragonjtë e përrallave
I doli përballë të keqes që na ngufate

17

SI ME NJERËZ TË HUAJ

Më duket se asgjë nuk mbaj mend
Asnjë fotografi
Nuk paska mbetur në kujtesën e fëmijërisë
Nuk di se si më dukej nëna
E çfarë mjekre kishte babai

Kjo dhomë e madhe
Më duket se ishte dy herë më e madhe
Dhe shtëpia kishte katër kate
Tani paska mbetur pa u ngrënë nga molat
Vetëm dhoma e fjetjes dhe kati i parë

Si me njerëz të huaj
Bisedoj me fqinjët e mi të vjetër
Unë nuk jam duke njohur askënd
Por edhe ata
Nuk më njohin më marrin për njeri të huaj

Çfarë të bëj me vetveten time
Ku të shkoj sonte
Më thanë se në varre nuk ka asnjë
Shtrat për të huajt
Në rrashtën time nuk shkruan se kush jam

ADEM ZAPLLUZHA

SI ME NJERËZ TË HUAJ

Më duket se asgjë nuk mbaj mend
Asnjë fotografi
Nuk paska mbetur në kujtesën e fëmijërisë
Nuk di se si më dukej nëna
E çfarë mjekre kishte babai

Kjo dhomë e madhe
Më duket se ishte dy herë më e madhe
Dhe shtëpia kishte katër kate
Tani paska mbetur pa u ngrënë nga molat
Vetëm dhoma e fjetjes dhe kati i parë

Si me njerëz të huaj
Bisedoj me fqinjët e mi të vjetër
Unë nuk jam duke njohur askënd
Por edhe ata
Nuk më njohin më marrin për njeri të huaj

Çfarë të bëj me vetveten time
Ku të shkoj sonte
Më thanë se në varre nuk ka asnjë
Shtrat për të huajt
Në rrashtën time nuk shkruan se kush jam

18

NËPËR HALLKAT E NDRYSHKURA

Gjithmonë kam pohuar
Se harresa nuk ekziston
Por ja që nuk qenka ashtu
Aq shumë më kanë lodhur odisejadat e sotme
Sa që ato të vjetrat i paskam harrua

Uliksi më duket si një vegim
Personazh i trilluar
Sa për të treguar përralla fëmijëve
Nuk dëgjohet lehja e qenit
Në gërmadhat e ndrydhura

Nëpër hallkat e oksiduara
Kalojnë vetëm merimangat e zeza
Dhe tregimet fantazmagorike
Për Trojën e djegur
Thua se për një grua do shkatërrohej shteti

Kuaj të drunjtë shoh për çdo ditë
Nëpër bedenat
E muranave të rrënuara
Shoh edhe njerëz të egër
Që nuk u shëmbëllejnë më njerëzve

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NËPËR HALLKAT E NDRYSHKURA

Gjithmonë kam pohuar
Se harresa nuk ekziston
Por ja që nuk qenka ashtu
Aq shumë më kanë lodhur odisejadat e sotme
Sa që ato të vjetrat i paskam harrua

Uliksi më duket si një vegim
Personazh i trilluar
Sa për të treguar përralla fëmijëve
Nuk dëgjohet lehja e qenit
Në gërmadhat e ndrydhura

Nëpër hallkat e oksiduara
Kalojnë vetëm merimangat e zeza
Dhe tregimet fantazmagorike
Për Trojën e djegur
Thua se për një grua do shkatërrohej shteti

Kuaj të drunjtë shoh për çdo ditë
Nëpër bedenat
E muranave të rrënuara
Shoh edhe njerëz të egër
Që nuk u shëmbëllejnë më njerëzve

19

SE ÇFARË DREQËRISH

Nuk di a thua vallë
Ju o njerëz të mirë
I dëgjoni hingëllimat
E kuajve të nëntokës
Dhe vrapin e egër të kaut të zi

Ose jetoni vetëm
Si ndonjë shurdhmemec
Që nuk i intereson asgjë
As zëzëllima e erës
Kur e sjell breshrin e zi

Unë ende nuk mësova
Se kush jeni
Nga erdhët në tokën tonë
Dhe na i dhunuat kishat
Tani mendoni se janë djepat e juaj

Shpeshherë më vjen ndërmend
Se çfarë dreqërish
Qenkan rritur në ata djepa
Të gdhendur nga rrapet e lashtë
Të fushës së Mëllenjave

ADEM ZAPLLUZHA

SE ÇFARË DREQËRISH

Nuk di a thua vallë
Ju o njerëz të mirë
I dëgjoni hingëllimat
E kuajve të nëntokës
Dhe vrapin e egër të kaut të zi

Ose jetoni vetëm
Si ndonjë shurdhmemec
Që nuk i intereson asgjë
As zëzëllima e erës
Kur e sjell breshrin e zi

Unë ende nuk mësova
Se kush jeni
Nga erdhët në tokën tonë
Dhe na i dhunuat kishat
Tani mendoni se janë djepat e juaj

Shpeshherë më vjen ndërmend
Se çfarë dreqërish
Qenkan rritur në ata djepa
Të gdhendur nga rrapet e lashtë
Të fushës së Mëllenjave

20

NUK E PRITE PENELOPA

Dikur vonë tepër vonë kuptova
Se Odiseja
Kurrë nuk kishte hipur në anijen
As që e kishin njohur marinarët

Si fëmijë i kishte adhuruar kungullakët
Dhe prej një kungulli të kalbur
Pat ndërtua një anije
Me të cilën e kishte marrë dynjanë në sy

Dikur vonë kur u kthye në atdhe
Nuk e prite Penelopa
Sepse s'ishte martuar asnjëherë me të
Ishte një njeri që i frikohej deteve

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NUK E PRITE PENELOPA

Dikur vonë tepër vonë kuptova
Se Odiseja
Kurrë nuk kishte hipur në anijen
As që e kishin njohur marinarët

Si fëmijë i kishte adhuruar kungullakët
Dhe prej një kungulli të kalbur
Pat ndërtua një anije
Me të cilën e kishte marrë dynjanë në sy

Dikur vonë kur u kthye në atdhe
Nuk e prite Penelopa
Sepse s'ishte martuar asnjëherë me të
Ishte një njeri që i frikohej deteve

21

ZOGJTË E TË GJITHA LLOJEVE

Lufta kishte përfunduar
Po ashtu edhe hingëllimat e kuajve
Nëpër llagëme flamujt dukeshin
Si paçavuret e lypsarëve
Asnjë ushtar nuk qante fatin e luftës

Era kishte dezertuar dhe nën pemët
E ngrira
Këndonte një serenatë dashurie
Sa që kishin zbritur në kopsht
Zogjtë e të gjitha llojeve

Vetëm një qyqe e bardhë
Qante në një degë të gjymtuar
Qante fatin e luftës
Askurrë nuk kishte përjetuar
Një fitore kaq të tmerrshme

Vjeshta ishte kah fundi i rrugëtimit
Dimri veç trokite
Trokite si i çmenduri në kanatat e thyera
Kurse dritaret e vjetra
Nuk ishin mbyllura asnjëherë

Prishtinë, 15 korrik 2018

ADEM ZAPLLUZHA

ZOGJTË E TË GJITHA LLOJEVE

Lufta kishte përfunduar
Po ashtu edhe hingëllimat e kuajve
Nëpër llagëme flamujt dukeshin
Si paçavuret e lypsarëve
Asnjë ushtar nuk qante fatin e luftës

Era kishte dezertuar dhe nën pemët
E ngrira
Këndonte një serenatë dashurie
Sa që kishin zbritur në kopsht
Zogjtë e të gjitha llojeve

Vetëm një qyqe e bardhë
Qante në një degë të gjymtuar
Qante fatin e luftës
Askurrë nuk kishte përjetuar
Një fitore kaq të tmerrshme

Vjeshta ishte kah fundi i rrugëtimit
Dimri veç trokite
Trokite si i çmenduri në kanatat e thyera
Kurse dritaret e vjetra
Nuk ishin mbyllura asnjëherë

Prishtinë, 15 korrik 2018

22

ATË DITË JANARI

E di nuk na kujtohet asgjë
Përpos shiut të zjarrtë
Që binte si vullkan
Mbi flokët e mia të thinjura
Shiu dhe çatia e rrënuar
Atë ditë janari qanin pa pra

Një binom i papërshkrueshëm
Ledhatonte me afsh pranveror
Lëkurën tënde të zeshktë
Stërkalat e ngrohta të shiut
Atë ditë janari qanin si një pegun
Ne ishim të qullur si shiu i çmendur

Të kujtohet nuk menin as zogjtë
Nën çatinë e kujtesës
Këndonte edhe era e shthurur
Kurse shiu i ngrohtë
Atë ditë janari
Ishte më i ngrohtë si asnjëherë më parë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ATË DITË JANARI

E di nuk na kujtohet asgjë
Përpos shiut të zjarrtë
Që binte si vullkan
Mbi flokët e mia të thinjura
Shiu dhe çatia e rrënuar
Atë ditë janari qanin pa pra

Një binom i papërshkrueshëm
Ledhatonte me afsh pranveror
Lëkurën tënde të zeshktë
Stërkalat e ngrohta të shiut
Atë ditë janari qanin si një pegun
Ne ishim të qullur si shiu i çmendur

Të kujtohet nuk menin as zogjtë
Nën çatinë e kujtesës
Këndonte edhe era e shthurur
Kurse shiu i ngrohtë
Atë ditë janari
Ishte më i ngrohtë si asnjëherë më parë

23

JETUAM ME MËKATIN TONË TË URREJTJES

Ne nuk e njohëm dashurinë
Druajtëm nga mëkati i perëndisë
Ndoshta Krishti ishte dashuria
Ose urrejtja e jonë
Ne nuk e njohëm dashurinë

Mes nesh qëndronte epshi
Qëndronte si lumi i çmendur
Që nuk e njihte derdhjen e vet
Andaj nuk e njohëm dashurinë
Nuk e njohëm sepse s'deshëm ta njohim

Jetuam me mëkatin tonë të urrejtjes
Ti ëndërroje meteorin tënd
Kurse unë diellin
I cili kurrë nuk më ngrohi
Në asnjë stinë gjithmonë ishte dimër

Jetuam me njëri – tjetrin
Jetuam si dy të lajthitur
Në një dhomë ku gjithmonë ishte dimër
Më duket se që në fillim gabuam
Ose e tërë bota kurrë se kuptoi dashurinë

ADEM ZAPLLUZHA

JETUAM ME MËKATIN TONË TË URREJTJES

Ne nuk e njohëm dashurinë
Druajtëm nga mëkati i perëndisë
Ndoshta Krishti ishte dashuria
Ose urrejtja e jonë
Ne nuk e njohëm dashurinë

Mes nesh qëndronte epshi
Qëndronte si lumi i çmendur
Që nuk e njihte derdhjen e vet
Andaj nuk e njohëm dashurinë
Nuk e njohëm sepse s'deshëm ta njohim

Jetuam me mëkatin tonë të urrejtjes
Ti ëndërroje meteorin tënd
Kurse unë diellin
I cili kurrë nuk më ngrohi
Në asnjë stinë gjithmonë ishte dimër

Jetuam me njëri – tjetrin
Jetuam si dy të lajthitur
Në një dhomë ku gjithmonë ishte dimër
Më duket se që në fillim gabuam
Ose e tërë bota kurrë se kuptoi dashurinë

24

KUR UDHËTON PA YJE

Shumë pak ka mbetur
Deri në qytet
Është udha e gjatë
Kur udhëton pa yje deri te portat e mbyllura
Kurse myshqet kurrë nuk na mësuan
Se si të orientohemi në errësirë

Më duket se edhe pak ka mbetur
Deri te pragjet e gurta
Si në ëndërr
Dëgjohet zëri i kambanës
Por kënga e zogjve
S'depërton nëpër errësirën e dendur

Ne ecëm njëqind dyqind vjet
Dhe ende nuk mbërrimë në qytet
Muret e ngritura kaq lart
Orë e çast po na pengojnë
Vetëm zëri i kambanës
Dëgjohet si nga një thellësi e padukshme

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KUR UDHËTON PA YJE

Shumë pak ka mbetur
Deri në qytet
Është udha e gjatë
Kur udhëton pa yje deri te portat e mbyllura
Kurse myshqet kurrë nuk na mësuan
Se si të orientohemi në errësirë

Më duket se edhe pak ka mbetur
Deri te pragjet e gurta
Si në ëndërr
Dëgjohet zëri i kambanës
Por kënga e zogjve
S'depërton nëpër errësirën e dendur

Ne ecëm njëqind dyqind vjet
Dhe ende nuk mbërrimë në qytet
Muret e ngritura kaq lart
Orë e çast po na pengojnë
Vetëm zëri i kambanës
Dëgjohet si nga një thellësi e padukshme

25

QË NJË DITË TË KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

Kur të huajt i mbyllin portat
Ekzistojnë njëqind mënyra
Se si mund të hapen
Por kur fluturojnë shtërgjet
Asnjëherë më
Nuk çilet dryni i heshtjes

Ja nga kjo shtëpi e lashtë
E lagjes sime
Nuk janë hapur asnjëherë dyert
Për herë të fundit u hapën
Kur i përcollëm për në amshim
Dy arkivole të karbonizuara

Këto rrugë të kalldrëmta
Çati të vjetra
Presin një dorë njeriu
Po që se vonohet edhe pak
S’do mbetet asnjë shpresë
Që një ditë të kthehen zogjtë e shiut

ADEM ZAPLLUZHA

QË NJË DITË TË KTHEHEN ZOGJTË E SHIUT

Kur të huajt i mbyllin portat
Ekzistojnë njëqind mënyra
Se si mund të hapen
Por kur fluturojnë shtërgjet
Asnjëherë më
Nuk çilet dryni i heshtjes

Ja nga kjo shtëpi e lashtë
E lagjes sime
Nuk janë hapur asnjëherë dyert
Për herë të fundit u hapën
Kur i përcollëm për në amshim
Dy arkivole të karbonizuara

Këto rrugë të kalldrëmta
Çati të vjetra
Presin një dorë njeriu
Po që se vonohet edhe pak
S’do mbetet asnjë shpresë
Që një ditë të kthehen zogjtë e shiut

26

TË ISHA AI QË NUK JAM

Të isha një gur i murrmë
Kurrë nuk do të isha i huaj
Në atdheun tim
Në vendin e shumë specieve
Që meritojnë dhe s'meritojnë të jenë këtu

Të isha një copë druri i kalbur
Do i përngjaja eshkës
Dhe do lëshoja dritë
Në atdheun tim të errësuar
Nga flamujt e njëqind kombeve

Të isha ai që nuk jam
Ndoshta miqtë e mi klandestin
Më kishin mbështjellë me dashuri
Kurse atdheu ah ky atdhe i askujt
Më kishte mësuar si vlerësohet njeriu

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

TË ISHA AI QË NUK JAM

Të isha një gur i murrmë
Kurrë nuk do të isha i huaj
Në atdheun tim
Në vendin e shumë specieve
Që meritojnë dhe s'meritojnë të jenë këtu

Të isha një copë druri i kalbur
Do i përngjaja eshkës
Dhe do lëshoja dritë
Në atdheun tim të errësuar
Nga flamujt e njëqind kombeve

Të isha ai që nuk jam
Ndoshta miqtë e mi klandestin
Më kishin mbështjellë me dashuri
Kurse atdheu ah ky atdhe i askujt
Më kishte mësuar si vlerësohet njeriu

27

LODHEN EDHE FLUTURAT E MOSHUARA

Gjërat që marrin frymë
Lodhen
Lodhen si dashuria
E cila e humb rrugën e instinktit
Nëpër të cilën kurrë nuk kaloi

Lodhen edhe njerëzit
Që marrin frymë nëpërmjet verzave
Lodhen si dashuria e bezdisshme
Kur mbërrin në fund të rrugës
Lodhen edhe fluturat e moshuara

Më kanë thënë se lodhen
Edhe shirat e vjeshtës
Andaj ja lëshojnë rrugën dimrit
Dhe ngricave të kristalta
Që frymojnë si stalagmitet

Çdo krijesë lodhet
Kur mbërrin në fund të udhës
Vetëm nëse nuk merr frymë si guri
Nuk e njeh lodhjen
As vetveten në atë udhëtim të gjatë

ADEM ZAPLLUZHA

LODHEN EDHE FLUTURAT E MOSHUARA

Gjërat që marrin frymë
Lodhen
Lodhen si dashuria
E cila e humb rrugën e instinktit
Nëpër të cilën kurrë nuk kaloi

Lodhen edhe njerëzit
Që marrin frymë nëpërmjet verzave
Lodhen si dashuria e bezdisshme
Kur mbërrin në fund të rrugës
Lodhen edhe fluturat e moshuara

Më kanë thënë se lodhen
Edhe shirat e vjeshtës
Andaj ja lëshojnë rrugën dimrit
Dhe ngricave të kristalta
Që frymojnë si stalagmitet

Çdo krijesë lodhet
Kur mbërrin në fund të udhës
Vetëm nëse nuk merr frymë si guri
Nuk e njeh lodhjen
As vetveten në atë udhëtim të gjatë

28

MBETA NJË VALLTAR I DRUNJTË

Mos më prek se prekjet e tua
Po e ndryshojnë itinerarin
E udhëtimit tim
Po më nxjerrin nga binarët e jetës
Së cilës nuk ja thitha asnjëherë nektarin

Njëherë desha të shndërrohem
Në bletë
Por thimthi i mbretëreshës
Aq thellë u ngul në tëmthin tim
Sa që u shtanga si një përmendore

Dhe asnjëherë më nuk pata forcë
Të hy në vallen e jetës
Mbeta një valltar i drunjtë
Kurse tingujt e një muzike të llahtarshme
Kurrë nuk pushuan në kokën time

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

MBETA NJË VALLTAR I DRUNJTË

Mos më prek se prekjet e tua
Po e ndryshojnë itinerarin
E udhëtimit tim
Po më nxjerrin nga binarët e jetës
Së cilës nuk ja thitha asnjëherë nektarin

Njëherë desha të shndërrohem
Në bletë
Por thimthi i mbretëreshës
Aq thellë u ngul në tëmthin tim
Sa që u shtanga si një përmendore

Dhe asnjëherë më nuk pata forcë
Të hy në vallen e jetës
Mbeta një valltar i drunjtë
Kurse tingujt e një muzike të llahtarshme
Kurrë nuk pushuan në kokën time

29

TË TILLË JEMI SI LOPA KRYENEÇE

Nga vetë natyra dhe fizionomia
Njeriu është harrestar
I fshin kujtimet më të mira
Për t'i mbajtur në mendje
Të gjitha ato të këqija

Më shumë na kujtohen çastet
Rreth gjellës së djegur
Se sa kur ishte gatimi fantastik
Të tillë jemi si lopa kryeneçe
Shqelmojmë kusinë
E mbushur me qumësht

Sërish jetojmë me të njëjtat gabime
Jemi mishëruar me të ligën
Në të shumtën e rasteve
Për ta mbushur Shpirtin
Me shtambën e urrejtjes
Harrojmë njëqind të mira

ADEM ZAPLLUZHA

TË TILLË JEMI SI LOPA KRYENEÇE

Nga vetë natyra dhe fizionomia
Njeriu është harrestar
I fshin kujtimet më të mira
Për t'i mbajtur në mendje
Të gjitha ato të këqija

Më shumë na kujtohen çastet
Rreth gjellës së djegur
Se sa kur ishte gatimi fantastik
Të tillë jemi si lopa kryeneçe
Shqelmojmë kusinë
E mbushur me qumësht

Sërish jetojmë me të njëjtat gabime
Jemi mishëruar me të ligën
Në të shumtën e rasteve
Për ta mbushur Shpirtin
Me shtambën e urrejtjes
Harrojmë njëqind të mira

30

U DËGJUAN BRITMAT E SHIUT

Mbrëmë mes një rrebeshi vetëtimash
Bisedova me zogjtë e shirave
Bisedova
Deri sa agullima
Qante mbi një kep të vetmuar

Qanin edhe dallgët
Në molin e vetmuar
Asnjë marinar nuk kishte mbërritur
Taverna e dehur prite me padurim
Kthimin e anijeve fantazmë

Nuk u kthye asnjë peshk
Vetëm tasat e zbrazura
Të konservave me afat të skaduar
Notonin mbi dallgët e çmendurat të Jonit
Notonin si anijet e vdekura

Mes një heshtjeje të llahtarshme
U dëgjuan britmat e shiut
I dëgjuam
Edhe piskamat e peshqve
Deti i trishtuar notonte në dhembjen e tij

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

U DËGJUAN BRITMAT E SHIUT

Mbrëmë mes një rrebeshi vetëtimash
Bisedova me zogjtë e shirave
Bisedova
Deri sa agullima
Qante mbi një kep të vetmuar

Qanin edhe dallgët
Në molin e vetmuar
Asnjë marinar nuk kishte mbërritur
Taverna e dehur prite me padurim
Kthimin e anijeve fantazmë

Nuk u kthye asnjë peshk
Vetëm tasat e zbrazura
Të konservave me afat të skaduar
Notonin mbi dallgët e çmendurat të Jonit
Notonin si anijet e vdekura

Mes një heshtjeje të llahtarshme
U dëgjuan britmat e shiut
I dëgjuam
Edhe piskamat e peshqve
Deti i trishtuar notonte në dhembjen e tij

31

AS ATA NUK MË NJIHNIN MUA

Dola nga një luftë e cila
Kurrë nuk ishte e imja
Nuk ishte as e huaj
Jetonte me mua më shumë
Çdo gjë që mund të jetojë

Më kujtohet si sot
Ishte pranverë e hershme
Dimri sapo kishte ikur
Pashë njerëz nëpër rrugë
Fytyrat e të cilëve nuk më kujtoheshin

As ata nuk më njihnin mua
Mbase edhe vetveten
Nuk më njihnin në atë katrahurë
Ishin të huaj në shpirtin e tyre
Dhe si të huaj silleshin vërdallë rrugëve

Pashë një luftë dhe njerëz
Me maska të zeza nëpër rrugë
Andaj edhe sot po them
Se lufta nuk ishte e imja
Erdhën djajtë e zinj dhe ma imponuan

ADEM ZAPLLUZHA

AS ATA NUK MË NJIHNIN MUA

Dola nga një luftë e cila
Kurrë nuk ishte e imja
Nuk ishte as e huaj
Jetonte me mua më shumë
Çdo gjë që mund të jetojë

Më kujtohet si sot
Ishte pranverë e hershme
Dimri sapo kishte ikur
Pashë njerëz nëpër rrugë
Fytyrat e të cilëve nuk më kujtoheshin

As ata nuk më njihnin mua
Mbase edhe vetveten
Nuk më njihnin në atë katrahurë
Ishin të huaj në shpirtin e tyre
Dhe si të huaj silleshin vërdallë rrugëve

Pashë një luftë dhe njerëz
Me maska të zeza nëpër rrugë
Andaj edhe sot po them
Se lufta nuk ishte e imja
Erdhën djajtë e zinj dhe ma imponuan

32

POR GJITHSESI I DËGJOJ LUKUNITË

Nuk di çfarë po ngjan
Me mua
Përbrenda meje dëgjoj zëra
Dëgjoj britmat e etërve
Që sillen vërdallë rreth kokës sime
Të ngujuar nga historia lavire

Sot nuk di ku jam
E ku do të jem nesër një Zot e di
Por gjithsesi i dëgjoj lukunitë
E kohërave të lashta
I dëgjoj
Thirrmat e trishtuara të etërve

Më kanë lodhur e dërmuar
Këto piskama të nëndheshme
Që nga koha e Uliksit
Atdheu im mbeti pa dyllë
Kurse britmat e cirqeve
Kurrë s’pushuan mbi këtë tokë të përvuajtur

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

POR GJITHSESI I DËGJOJ LUKUNITË

Nuk di çfarë po ngjan
Me mua
Përbrenda meje dëgjoj zëra
Dëgjoj britmat e etërve
Që sillen vërdallë rreth kokës sime
Të ngujuar nga historia lavire

Sot nuk di ku jam
E ku do të jem nesër një Zot e di
Por gjithsesi i dëgjoj lukunitë
E kohërave të lashta
I dëgjoj
Thirrmat e trishtuara të etërve

Më kanë lodhur e dërmuar
Këto piskama të nëndheshme
Që nga koha e Uliksit
Atdheu im mbeti pa dyllë
Kurse britmat e cirqeve
Kurrë s’pushuan mbi këtë tokë të përvuajtur

33

DO VIJNË EDHE FLUTURAT

Do të vij një ditë e një kohë
Kur do të arratisem nga vetvetja
Pas meje
Do vijnë zogjtë e shirave
Dhe shtërgjet
Që kurrë nuk i takova në atdheun tim

Do vijnë edhe fluturat
Me të gjitha speciet e zogjve
Do fluturojnë
Nëpër errësirën e kozmosit
Do fluturojnë deri atje
Nga ku zbritën etërit tanë krenar

Sa herë që deshëm të kapërcejmë
Nën ngjyrat e kaltra të ylberit
Një mallkim i lashtë
Tepër i lashtë
Na hyri në shpirt
Dhe kurrë më nuk e pamë dritën me sy

ADEM ZAPLLUZHA

DO VIJNË EDHE FLUTURAT

Do të vij një ditë e një kohë
Kur do të arratisem nga vetvetja
Pas meje
Do vijnë zogjtë e shirave
Dhe shtërgjet
Që kurrë nuk i takova në atdheun tim

Do vijnë edhe fluturat
Me të gjitha speciet e zogjve
Do fluturojnë
Nëpër errësirën e kozmosit
Do fluturojnë deri atje
Nga ku zbritën etërit tanë krenar

Sa herë që deshëm të kapërcejmë
Nën ngjyrat e kaltra të ylberit
Një mallkim i lashtë
Tepër i lashtë
Na hyri në shpirt
Dhe kurrë më nuk e pamë dritën me sy

34

ASKUJT MOS IU MBËSHTET

Mos lëviz kurrë
Në kundërshtim me vetveten
As erës mos i dil përballë
Njëmijë e një peripeci
Do ta rrezikojnë ekzistencën

Ec aq sa mund të të bartin këmbët
Askujt mos iu mbështet
As mos lejo
Të bëhesh shtyllë mbështetëse
Për ndonjë kalimtar të vonuar

Nëse je kundër erës ti do jesh
Edhe kundër vetvetes
Dhe zogjve të shiut
Që fluturojnë
Gjithmonë përballë stuhiv

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ASKUJT MOS IU MBËSHTET

Mos lëviz kurrë
Në kundërshtim me vetveten
As erës mos i dil përballë
Njëmijë e një peripeci
Do ta rrezikojnë ekzistencën

Ec aq sa mund të të bartin këmbët
Askujt mos iu mbështet
As mos lejo
Të bëhesh shtyllë mbështetëse
Për ndonjë kalimtar të vonuar

Nëse je kundër erës ti do jesh
Edhe kundër vetvetes
Dhe zogjve të shiut
Që fluturojnë
Gjithmonë përballë stuhiv

35

NË AJRIN E TYMOSUR TË QYTETIT FANTAZMË

Sonte do t'i lë të lira gjymtyrët
Le të lëvizin nëpër çdo drejtim
Ku ecën dhe merr frymë njeriu
Një pjesë e dorës së djathtë
Do ta gozhdoj për vetullat e mjegullave
Duke imituar gozhdimin e Krishtit
Për drurin e njomë të rrapit

Nga oktopodët kam mësuar
Se si lëvizet me lehtësi
Kundër rrymimit të dallgëve
Të dalloj për mrekulli
Urinimin e gjallesave nënujore
Dhe të notoj si peshku
Nëpër një hapësirë të zbrazët

ADEM ZAPLLUZHA

NË AJRIN E TYMOSUR TË QYTETIT FANTAZMË

Sonte do t'i lë të lira gjymtyrët
Le të lëvizin nëpër çdo drejtim
Ku ecën dhe merr frymë njeriu
Një pjesë e dorës së djathtë
Do ta gozhdoj për vetullat e mjegullave
Duke imituar gozhdimin e Krishtit
Për drurin e njomë të rrapit

Nga oktopodët kam mësuar
Se si lëvizet me lehtësi
Kundër rrymimit të dallgëve
Të dalloj për mrekulli
Urinimin e gjallesave nënujore
Dhe të notoj si peshku
Nëpër një hapësirë të zbrazët

36

Nuk paraqet problem dhembja e kokës sime
Edhe ashtu
Kurrë nuk kam qenë më mirë me shëndet
Mund t’i shkuli nga shpirti im
Të gjitha dhembjet
Dhe t’i mbjelli për mëkatarët eliksiret
Në ajrin e tymosur të qytetit fantazmë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Nuk paraqet problem dhembja e kokës sime
Edhe ashtu
Kurrë nuk kam qenë më mirë me shëndet
Mund t’i shkuli nga shpirti im
Të gjitha dhembjet
Dhe t’i mbjelli për mëkatarët eliksiret
Në ajrin e tymosur të qytetit fantazmë

37

ME PENSIONIN E FUNDIT PATA FAT

Për çdo ditë plakemi nga pak
Na rriten këmishët
Pantallonat e vjetra
Janë zgjatur më së paku për dy gishta
Kurse mjekra e thinjur rritet pa masë

Këpucët e vjetra më kanë mbetur
Në një skutë
Si në ndonjë muze arkaik
Askush nuk mund t'i përdor
Më duket se janë shlyer edhe shollat

Pallton e vitit të kaluar
Vështirë se mund ta përdori sivjet
Ndoshta edhe s'do të kem kohë
Më janë grisur çorapet
Thua se janë të kafshuar nga minjtë

Me pensionin e fundit pata fat
Të blej një qivur të vjetër
Domosdo më duhet
Të mendoj edhe për botën tjetër
S'shkohet vallë dosido mbase edhe në ferr
Prishtinë, 16 korrik 2018

ADEM ZAPLLUZHA

ME PENSIONIN E FUNDIT PATA FAT

Për çdo ditë plakemi nga pak
Na rriten këmishët
Pantallonat e vjetra
Janë zgjatur më së paku për dy gishta
Kurse mjekra e thinjur rritet pa masë

Këpucët e vjetra më kanë mbetur
Në një skutë
Si në ndonjë muze arkaik
Askush nuk mund t'i përdor
Më duket se janë shlyer edhe shollat

Pallton e vitit të kaluar
Vështirë se mund ta përdori sivjet
Ndoshta edhe s'do të kem kohë
Më janë grisur çorapet
Thua se janë të kafshuar nga minjtë

Me pensionin e fundit pata fat
Të blej një qivur të vjetër
Domosdo më duhet
Të mendoj edhe për botën tjetër
S'shkohet vallë dosido mbase edhe në ferr
Prishtinë, 16 korrik 2018

38

Cikli i dytë
Është koha e kthimit në atdhe

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Cikli i dytë
Është koha e kthimit në atdhe

39

ADEM ZAPLLUZHA

40

PËR TË QENË BURRA TË BESËS

Njerëzit gjithmonë flasin
Për atë se çfarë u mungon
Përqafojnë dhe
Dashurojnë në ëndërr
Netëve të vona
Çojnë dashuri me kukulla

Në çdo të dytën fjalë
Si qumështi grafullon patriotizmi
Kur ishte koha për të
E futëm kokën si struci në rërë
Ik prapanicë se të lashë
E sot kërthndezemi si këndesat
Kur jemi pranë pulave të zgërlaqura

Për të qenë burra të besës
Krijuam një institucion
Pas të cilit i fshihnim të palarat tona
I fshihnin pandershmëritë
Me një fjalë thjesht
Pasha besën dhe këtu lëshoheshin
Perdet e ndyra të pabesisë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

PËR TË QENË BURRA TË BESËS

Njerëzit gjithmonë flasin
Për atë se çfarë u mungon
Përqafojnë dhe
Dashurojnë në ëndërr
Netëve të vona
Çojnë dashuri me kukulla

Në çdo të dytën fjalë
Si qumështi grafullon patriotizmi
Kur ishte koha për të
E futëm kokën si struci në rërë
Ik prapanicë se të lashë
E sot kërthndezemi si këndesat
Kur jemi pranë pulave të zgërlaqura

Për të qenë burra të besës
Krijuam një institucion
Pas të cilit i fshihnim të palarat tona
I fshihnin pandershmëritë
Me një fjalë thjesht
Pasha besën dhe këtu lëshoheshin
Perdet e ndyra të pabesisë

41

TI VETËM DËGJO SONTE

Mos thuaj asnjë fjalë
Sonte le të flasin pemët
Dëgjo me kujdes
Korin e bretkosave
Dëgjo këngët korale të gjetheve

Kjo melodi përsëritet
Vetëm njëherë në njëqind vjet
Dhe kurrë më nuk dëgjojmë tinguj gjethesh
Dëgjoje heshtjen e manaferrave
As lule s'çelin për mëngjesin e plagosur

Mos i prek yjet endacakë
Me shikimet e tua vrastare
Mos se shndërrohen në meteor
Ti vetëm dëgjo sonte këngët korale
Sa bukur këndojnë pemët kur çelin dashuri

ADEM ZAPLLUZHA

TI VETËM DËGJO SONTE

Mos thuaj asnjë fjalë
Sonte le të flasin pemët
Dëgjo me kujdes
Korin e bretkosave
Dëgjo këngët korale të gjetheve

Kjo melodi përsëritet
Vetëm njëherë në njëqind vjet
Dhe kurrë më nuk dëgjojmë tinguj gjethesh
Dëgjoje heshtjen e manaferrave
As lule s'çelin për mëngjesin e plagosur

Mos i prek yjet endacakë
Me shikimet e tua vrastare
Mos se shndërrohen në meteor
Ti vetëm dëgjo sonte këngët korale
Sa bukur këndojnë pemët kur çelin dashuri

42

SI TË KUPTOJ SE KUSH JAM SOT

Nuk di jam gur ose njeri
Por gjithsesi
Diçka mes njeriut dhe gurit
Një copë mishi i ndrydhur
Dhe i shtrydhur nga sistemet

Mbi kokën time reshën stinët
Dimri dhe vjeshta
Mbetën pa asnjë ëndërr
Kurse pranvera dhe vera
Deri në asht m'i zhveshën kujtimet

Më thoni se kush jam sot
Nga gjymtyrët e mi
Çfarë nuk punuan njerëzit
Sëpata dhe ushta prej gurëve
Gatuan edhe njeriun nga gjaku im

Si të kuptoj se kush jam sot
Të gjithë heshtni
Asnjëri asnjë fjalë nuk thotë
Sa shumë shëmbëllejnë me rrapin
Heshtin si guri i stralltë i atdheut tim

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

SI TË KUPTOJ SE KUSH JAM SOT

Nuk di jam gur ose njeri
Por gjithsesi
Diçka mes njeriut dhe gurit
Një copë mishi i ndrydhur
Dhe i shtrydhur nga sistemet

Mbi kokën time reshën stinët
Dimri dhe vjeshta
Mbetën pa asnjë ëndërr
Kurse pranvera dhe vera
Deri në asht m'i zhveshën kujtimet

Më thoni se kush jam sot
Nga gjymtyrët e mi
Çfarë nuk punuan njerëzit
Sëpata dhe ushta prej gurëve
Gatuan edhe njeriun nga gjaku im

Si të kuptoj se kush jam sot
Të gjithë heshtni
Asnjëri asnjë fjalë nuk thotë
Sa shumë shëmbëllejnë me rrapin
Heshtin si guri i stralltë i atdheut tim

43

JU THASHË SE MË PATËN THËNË

Për habinë e të gjithëve
Mbi kurmin tim
Kanë zënë fill e po çelin
Disa lule të panjohura deri më sot
Po qelin buzëqeshjet e gurëve

Më patën thënë dikur e në një kohë
Se në varre
Nuk do të mbjellin më lule
Por gurë të murrmë
Që do u shëmbëllejnë trishtimeve

Ju thashë se më patën thënë
Por unë të thënave
Kurrë nuk u kam besuar
Andaj mbi kurmin tim sot po çelin
Lulet më të bukura të dynjasë

ADEM ZAPLLUZHA

JU THASHË SE MË PATËN THËNË

Për habinë e të gjithëve
Mbi kurmin tim
Kanë zënë fill e po çelin
Disa lule të panjohura deri më sot
Po qelin buzëqeshjet e gurëve

Më patën thënë dikur e në një kohë
Se në varre
Nuk do të mbjellin më lule
Por gurë të murrmë
Që do u shëmbëllejnë trishtimeve

Ju thashë se më patën thënë
Por unë të thënave
Kurrë nuk u kam besuar
Andaj mbi kurmin tim sot po çelin
Lulet më të bukura të dynjasë

44

VETËM BASTUNIT TIM JA DI EMRIN

I paskam harruar emrat e sendeve
Nuk di më se si quhet lulja
Që rri e vetmuar në saksi
Ose sa gjethe i ka tërfili i egër
Asgjë më nuk më vjen ndër mend

Më kujtohen vetëm emrat e pemëve
Dhe të rrapeve
Gjembat e trëndafilit si mund t'i harroj
Kur aq trishtueshëm ma grithën lëkurën
Më dukeshin si thonjtë e maces së egër

Vetëm bastunit tim ja di emrin
Dhe vendin ku qëndron
Për çdo ditë më shoqëron në tavernë
Ku në duet e pimë
Kafenë e përditshme të mëkatit

Më kujtohen këpucët
Edhe palltoja ime e murrme
Që nuk ndahen asnjëherë prej meje
Thua se jemi binjakët siamez
Ndoshta do më përcjellin deri në amshim

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

VETËM BASTUNIT TIM JA DI EMRIN

I paskam harruar emrat e sendeve
Nuk di më se si quhet lulja
Që rri e vetmuar në saksi
Ose sa gjethe i ka tërfili i egër
Asgjë më nuk më vjen ndër mend

Më kujtohen vetëm emrat e pemëve
Dhe të rrapeve
Gjembat e trëndafilit si mund t'i harroj
Kur aq trishtueshëm ma grithën lëkurën
Më dukeshin si thonjtë e maces së egër

Vetëm bastunit tim ja di emrin
Dhe vendin ku qëndron
Për çdo ditë më shoqëron në tavernë
Ku në duet e pimë
Kafenë e përditshme të mëkatit

Më kujtohen këpucët
Edhe palltoja ime e murrme
Që nuk ndahen asnjëherë prej meje
Thua se jemi binjakët siamez
Ndoshta do më përcjellin deri në amshim

45

TË NGRITUR NGA HAJDUTËRIA

Njëqind vjet mbi dyqind katastrofa
Derdhëm lot
Nuk patëm kohë as t'i rrisim fëmijët
Vinte një ushtri vrastare
Më e çmendur se ajo paraprakja

Por me trastë të ngarkuara
Ktheheshin në atdheun e tyre
Të ngritur nga hajdutëria
Të ngritur
Mbi gërmadhat e eshtrave të një kombi

Askush nuk e qante kokën
Për lotët e derdhura të nënave
Nëpër sallonet e Evropës
Mbaheshin koncerte me shtatë violina
Mbaheshin për asimilimin e një kombi

ADEM ZAPLLUZHA

TË NGRITUR NGA HAJDUTËRIA

Njëqind vjet mbi dyqind katastrofa
Derdhëm lot
Nuk patëm kohë as t'i rrisim fëmijët
Vinte një ushtri vrastare
Më e çmendur se ajo paraprakja

Por me trastë të ngarkuara
Ktheheshin në atdheun e tyre
Të ngritur nga hajdutëria
Të ngritur
Mbi gërmadhat e eshtrave të një kombi

Askush nuk e qante kokën
Për lotët e derdhura të nënave
Nëpër sallonet e Evropës
Mbaheshin koncerte me shtatë violina
Mbaheshin për asimilimin e një kombi

46

NE I PAMË TRISHTIMET E ZOGJVE TË SHIUT

Asgjë në jetë nuk vlen
Nëse matet me kandarin e urrejtjes
Merr frymë pak
Derisa i numëron
Rruzaret e vjedhura të erës
Nga syri i hënës së djersitur pikon loti

Na i pamë trishtimet e zogjve të shiut
Përjetuam ikjet e dezertorëve
Mbi një fushë të pikëllimit
Me flamuj të grisur ishin mbuluar kufomat
Pemët kundërmonin trishtim
Nga kundërmimi i vdekjes vdiste bari fishkur

Sot nuk është një ditë e lumtur
Mbi tokën e zhubrosur dhe të djegur
Dhe nën degët e thyera
Dëgjohen krakëllimat e korbave
Një çafkë e larme
Me një shtambë prej argjile i ujit pemët

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NE I PAMË TRISHTIMET E ZOGJVE TË SHIUT

Asgjë në jetë nuk vlen
Nëse matet me kandarin e urrejtjes
Merr frymë pak
Derisa i numëron
Rruzaret e vjedhura të erës
Nga syri i hënës së djersitur pikon loti

Na i pamë trishtimet e zogjve të shiut
Përjetuam ikjet e dezertorëve
Mbi një fushë të pikëllimit
Me flamuj të grisur ishin mbuluar kufomat
Pemët kundërmonin trishtim
Nga kundërmimi i vdekjes vdiste bari fishkur

Sot nuk është një ditë e lumtur
Mbi tokën e zhubrosur dhe të djegur
Dhe nën degët e thyera
Dëgjohen krakëllimat e korbave
Një çafkë e larme
Me një shtambë prej argjile i ujit pemët

47

Nuk pata kohë për koncertin
E muzikantëve klandestin
Ishte një ditë e trishtueshme
Me shi të turbullt
Nga lotët e qiellit të ngrysur
I ujitëm fushat e vdekura të dhembjet

ADEM ZAPLLUZHA

Nuk pata kohë për koncertin
E muzikantëve klandestin
Ishte një ditë e trishtueshme
Me shi të turbullt
Nga lotët e qiellit të ngrysur
I ujitëm fushat e vdekura të dhembjet

48

NËN QEPALLAT E KËPUTURA TË NATËS

Meqenëse kurrë nuk u takuan
Shikimet tona
Si mund të ekzistoj mundësia
Që ti kaq e madhe
Të fundosesh në sytë e mi
Ja pra u fundose dhe mbete pengë
Në morfologjinë e ngjyrave

Ishte ditë e diel kur nga etja
Dëneste kaktusi
Dënesnin edhe gjembat e venitur
Ku ishe ti
Kur ylberi mbeti pa asnjë imazh
Qielli atë ditë si flamur lufte
Dukej i grisur në shtatëqind pjesë

Më duket se kaluan aq shumë vite
Sa që harresa zuri vend
Nën qepallat e këputura të natës
Asnjë shtegtar rebel
Nuk u ndal te portat e faltores
Kishin humbur besimin
Në tingujt shurdhmemece të kambanës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NËN QEPALLAT E KËPUTURA TË NATËS

Meqenëse kurrë nuk u takuan
Shikimet tona
Si mund të ekzistoj mundësia
Që ti kaq e madhe
Të fundosesh në sytë e mi
Ja pra u fundose dhe mbete pengë
Në morfologjinë e ngjyrave

Ishte ditë e diel kur nga etja
Dëneste kaktusi
Dënesnin edhe gjembat e venitur
Ku ishe ti
Kur ylberi mbeti pa asnjë imazh
Qielli atë ditë si flamur lufte
Dukej i grisur në shtatëqind pjesë

Më duket se kaluan aq shumë vite
Sa që harresa zuri vend
Nën qepallat e këputura të natës
Asnjë shtegtar rebel
Nuk u ndal te portat e faltores
Kishin humbur besimin
Në tingujt shurdhmemece të kambanës

49

ËSHTË KOHA E KTHIMIT NË ATDHE

Unë nuk thashë se kanë vdekur stinët
As nuk pohova
Të kundërtën e asaj
Se çfarë mendoj për ekzistencën
Dielli sot lindi shumë vonë
Sa që eklipsi do të ngjaj një tjetër ditë

Ju lutem mos i prekni petalet e mjegullave
Sot është koha e përshtatshme
Për ngjizjen e shirave
Po që se i takojmë në hapësirë
Fluturimet e shtërgjeve
Mos mendoni se është koha e ikjeve

Ne nuk kemi një tjetër atdhe
Kjo tokë e lashtë e etërve
Mund të na mbaj gjallë edhe pesëmijë
Ose dhjetë mijë e më shumë vite
Ndaleni fluturimet e çmendura
Është koha e kthimit në atdhe

Prishtinë, 17 korrik, 2018

ADEM ZAPLLUZHA

ËSHTË KOHA E KTHIMIT NË ATDHE

Unë nuk thashë se kanë vdekur stinët
As nuk pohova
Të kundërtën e asaj
Se çfarë mendoj për ekzistencën
Dielli sot lindi shumë vonë
Sa që eklipsi do të ngjaj një tjetër ditë

Ju lutem mos i prekni petalet e mjegullave
Sot është koha e përshtatshme
Për ngjizjen e shirave
Po që se i takojmë në hapësirë
Fluturimet e shtërgjeve
Mos mendoni se është koha e ikjeve

Ne nuk kemi një tjetër atdhe
Kjo tokë e lashtë e etërve
Mund të na mbaj gjallë edhe pesëmijë
Ose dhjetë mijë e më shumë vite
Ndaleni fluturimet e çmendura
Është koha e kthimit në atdhe

Prishtinë, 17 korrik, 2018

50

KËMISHA IME ME GJEMBA TË ARGJENDTA

Këmisha ime prej shiu
I shëmbëllen letrës së stanjollit
Sa herë që i ndjen stërkalat
Mbi shpatullat e saja
I duket vetja
Si një luadh me trëndafila

I ka njëqind e një mijë ngjyra
Sa që i mashtron fluturat e kaltra
Këmisha ime prej shiu
Një ditë duket si luadh
Kurse ditën tjetër
Ngjan me shkretëtirën e Saharës

Ja pra se si duket kjo këmishë
Me qindra arna
Ku fshihen me delikates
Kandrat e të gjitha llojeve
Këmisha ime me trëndafila
Këmisha ime me gjemba të argjendta

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KËMISHA IME ME GJEMBA TË ARGJENDTA

Këmisha ime prej shiu
I shëmbëllen letrës së stanjollit
Sa herë që i ndjen stërkalat
Mbi shpatullat e saja
I duket vetja
Si një luadh me trëndafila

I ka njëqind e një mijë ngjyra
Sa që i mashtron fluturat e kaltra
Këmisha ime prej shiu
Një ditë duket si luadh
Kurse ditën tjetër
Ngjan me shkretëtirën e Saharës

Ja pra se si duket kjo këmishë
Me qindra arna
Ku fshihen me delikates
Kandrat e të gjitha llojeve
Këmisha ime me trëndafila
Këmisha ime me gjemba të argjendta

51

MË SHUMË E VRET VETVETEN SE SA ARMIKUN

Vjeshta sapo kishte ikur
Erdhi një dimër i acartë
Nga të katër anët pjalmonte trishtimi
Depërtimi i plumbit në ashtë
Ishte më i thellë se çdo klithmë
Ngjante me detin e dhembjeve

Askush pranë rrapit të plagosur
Gjëma e lisave
Dëgjohej diku larg
Dëgjohej një britmë e pa artikuluar
Shumë më larg sa pesha e dhembjes
Bari i fishkur ofshante si kërthi

Kujt t'i ankohem në këto çaste
Gjethet shurdhmemece
Nuk tregojnë asnjë shenjë
Se po e kuptojnë dhembjen time
Sa e thellë kjo plagë shrapneli
Në shtatin e lisit të plagosur

ADEM ZAPLLUZHA

MË SHUMË E VRET VETVETEN SE SA ARMIKUN

Vjeshta sapo kishte ikur
Erdhi një dimër i acartë
Nga të katër anët pjalmonte trishtimi
Depërtimi i plumbit në ashtë
Ishte më i thellë se çdo klithmë
Ngjante me detin e dhembjeve

Askush pranë rrapit të plagosur
Gjëma e lisave
Dëgjohej diku larg
Dëgjohej një britmë e pa artikuluar
Shumë më larg sa pesha e dhembjes
Bari i fishkur ofshante si kërthi

Kujt t'i ankohem në këto çaste
Gjethet shurdhmemece
Nuk tregojnë asnjë shenjë
Se po e kuptojnë dhembjen time
Sa e thellë kjo plagë shrapneli
Në shtatin e lisit të plagosur

52

Në luftë nuk ka njerëz të mirë
E as të këqij
Të gjithë janë të çmendur
Marrëzia e tyre udhëton pa itinerar
Më duket se secili ushtar
Më shumë e vret vetveten se sa armikun

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Në luftë nuk ka njerëz të mirë
E as të këqij
Të gjithë janë të çmendur
Marrëzia e tyre udhëton pa itinerar
Më duket se secili ushtar
Më shumë e vret vetveten se sa armikun

NË DITARIN E ERËS

Me një çekan prej shiu
I godas rrufetë
Nga mjegullat e hirta
Shtrydhi trishtimin e vetëtimave
E shiu i baltosur na i kreh flokët
E këputura nga rrufetë

Rrugët si krijesa të babëzitura
Kullojnë frikë
Nga rrjedha e furishme e lumenjve
Janë zënë kanalizimet
Nëpër shëtitoret e qytetit fantazmë
Paskan dalë kufomat e etërve

Vetëm kronisti me kukëza prej plastike
Nga një skutë e vjetër
Në ditarin e erës
Shënon diçka të llahtarshme
Mbase shënon me kujdes kufomat
Që notojnë si kërcu nëpër qendrën e qytetit

ADEM ZAPLLUZHA

NË DITARIN E ERËS

Me një çekan prej shiu
I godas rrufetë
Nga mjegullat e hirta
Shtrydhi trishtimin e vetëtimave
E shiu i baltosur na i kreh flokët
E këputura nga rrufetë

Rrugët si krijesa të babëzitura
Kullojnë frikë
Nga rrjedha e furishme e lumenjve
Janë zënë kanalizimet
Nëpër shëtitoret e qytetit fantazmë
Paskan dalë kufomat e etërve

Vetëm kronisti me kukëza prej plastike
Nga një skutë e vjetër
Në ditarin e erës
Shënon diçka të llahtarshme
Mbase shënon me kujdes kufomat
Që notojnë si kërcu nëpër qendrën e qytetit

54

DIÇKA E MISTERSHME

Asnjë zog nuk hyri
As nuk doli nga qyteti
Të mbuluara me një veladon të zi
Kalldrëmet Ilire koteshin
Në diellin vjeshtak të shatërvanit

Thonë se në këtë stinët
Të vonshëm
Shteren lëfytet e metalta
Pikë ujë s'do të ketë
Për kalimtarët e vonuar të natës

Një erë e fortë lozonjare
Si në ndonjë daulle të vjetër
I binte qepenave
Të gozhduara të dyqaneve
Sot askush nuk i përfilli ritet fetare

Mejtën edhe kambanat e kishës katolike
As ato ortodokse nuk u ndien gjallë
Diçka e mistershme
Po zihet
Pas portave të mbyllura me dyllë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

DIÇKA E MISTERSHME

Asnjë zog nuk hyri
As nuk doli nga qyteti
Të mbuluara me një veladon të zi
Kalldrëmet Ilire koteshin
Në diellin vjeshtak të shatërvanit

Thonë se në këtë stinët
Të vonshëm
Shteren lëfytet e metalta
Pikë ujë s'do të ketë
Për kalimtarët e vonuar të natës

Një erë e fortë lozonjare
Si në ndonjë daulle të vjetër
I binte qepenave
Të gozhduara të dyqaneve
Sot askush nuk i përfilli ritet fetare

Mejtën edhe kambanat e kishës katolike
As ato ortodokse nuk u ndien gjallë
Diçka e mistershme
Po zihet
Pas portave të mbyllura me dyllë

55

JAM NGRITUR MBI VETVETEN

Sa herë që kisha rrënje në jetë
Dy herë më i fortë
Jam ngritur mbi vetveten
Mbase më duheshin rëniet
Që të ngritëm
Dhe të mos zvarritem pranë askujt

Nuk jam nga fisi i titanëve
Jam thjesht një njeri i vogël
Në damarët e të cilit si dallgë deti
Gjaku im i rreh brigjet e kujtesës
I rreh me fjalë shpirtin
Dhe besën e etërve të mi Dardanë

ADEM ZAPLLUZHA

JAM NGRITUR MBI VETVETEN

Sa herë që kisha rrënje në jetë
Dy herë më i fortë
Jam ngritur mbi vetveten
Mbase më duheshin rëniet
Që të ngritëm
Dhe të mos zvarritem pranë askujt

Nuk jam nga fisi i titanëve
Jam thjesht një njeri i vogël
Në damarët e të cilit si dallgë deti
Gjaku im i rreh brigjet e kujtesës
I rreh me fjalë shpirtin
Dhe besën e etërve të mi Dardanë

56

NË ADN-në TONË

Meqenëse s’desha të dëgjoj
Kujën e daulleve
Vajtimet kurrë nuk më kanë pëlqyer
Ashtu siç nuk më ka pëlqyer
Grithja e fytyrave

Në gadishullin Ilirik
Kanë qenë të ndaluara vajet
As vigmat nuk i patëm në gjak
Në ADN-në tonë
Gjithmonë vaji i burrit ishte kënga

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

NË ADN-në TONË

Meqenëse s’desha të dëgjoj
Kujën e daulleve
Vajtimet kurrë nuk më kanë pëlqyer
Ashtu siç nuk më ka pëlqyer
Grithja e fytyrave

Në gadishullin Ilirik
Kanë qenë të ndaluara vajet
As vigmat nuk i patëm në gjak
Në ADN-në tonë
Gjithmonë vaji i burrit ishte kënga

57

AS NË CELEBRIMIN E MESHËS SIME LAMTUMIRËSE

Nuk di për të tjerët
Por unë gjithmonë vonohem
Mbase jam njeri i vonshëm
Kurrë nuk mund t'i ndali
Akrepat e orës
Të mos lëvizin
Në kundërshtim me dëshirat e mia

Sa herë që e kurdisa celularin
Të më zgjoj më herët
Si për inat
Unë zgjohesha
Çdoherë dy orë më vonë
Kështu që takimet e ditës
Më dukeshin humbje kohe

Meqenëse nuk mund të ndryshoj unë
Më duhet domosdo
Të gjej një tjetër rrugë
Për ta ndryshuar kohën
Sepse nëse vonohem kështu gjithmonë
Nuk do të mund të mbërri
As në celebrimin
E meshës sime të fundme

ADEM ZAPLLUZHA

AS NË CELEBRIMIN E MESHËS SIME LAMTUMIRËSE

Nuk di për të tjerët
Por unë gjithmonë vonohem
Mbase jam njeri i vonshëm
Kurrë nuk mund t'i ndali
Akrepat e orës
Të mos lëvizin
Në kundërshtim me dëshirat e mia

Sa herë që e kurdisa celularin
Të më zgjoj më herët
Si për inat
Unë zgjohesha
Çdoherë dy orë më vonë
Kështu që takimet e ditës
Më dukeshin humbje kohe

Meqenëse nuk mund të ndryshoj unë
Më duhet domosdo
Të gjej një tjetër rrugë
Për ta ndryshuar kohën
Sepse nëse vonohem kështu gjithmonë
Nuk do të mund të mbërri
As në celebrimin
E meshës sime të fundme

58

ISHTE NJË DËNIM I PAPARË

Me ju thënë të drejtën
Mbaj mend shumë
Por si për inat
Gjërat e mira nuk më kujtohen
Ato të ligat kurrë nuk i harroj

Më kujtohet kur për festën
E kërshëndellave
I grisa pantallonat e fqinjit tim
I grisa në shenjë hakmarrjeje
Sepse për festën time ma grisi flamurin

Isha i vockël sa një gisht
Por për dykrenorin asnjëherë
Nuk kam kontrolluar vetveten
Me një rast pata grisur fotografinë
E një udhëheqësi shtetëror në klasë

Ishte një dënim i paparë
Drejtori i shkollës një tullac pa flokë
Ma konfiskoi abetaren
Dhe kurrë më nuk e pashë atë libër të shenjtë
Për të cilin i syrgjynoseshin etërit tanë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ISHTE NJË DËNIM I PAPARË

Me ju thënë të drejtën
Mbaj mend shumë
Por si për inat
Gjërat e mira nuk më kujtohen
Ato të ligat kurrë nuk i harroj

Më kujtohet kur për festën
E kërshëndellave
I grisa pantallonat e fqinjit tim
I grisa në shenjë hakmarrjeje
Sepse për festën time ma grisi flamurin

Isha i vockël sa një gisht
Por për dykrenorin asnjëherë
Nuk kam kontrolluar vetveten
Me një rast pata grisur fotografinë
E një udhëheqësi shtetëror në klasë

Ishte një dënim i paparë
Drejtori i shkollës një tullac pa flokë
Ma konfiskoi abetaren
Dhe kurrë më nuk e pashë atë libër të shenjtë
Për të cilin i syrgjynoseshin etërit tanë

59

SEPSE MË KA MBETUR NJË FRIKË

Kur hy në dhomën e punës
Me mua janë të gjitha zanoret
Nuk mungojnë as bashkëtingëlloret
Pentagrami mbi divanin e grisur
Përjeton zbritjen dhe ngritjen e notave

Sa herë që e theva çelësin e violinës
Si çafkat e zeza telat e kitarës
Ikën nga dhoma ime
Thua se kurrë nuk do dëgjohet
Kori imagjinar i bretkosave

Muzika e një lashtësie të padukshme
Fshihej mes sirtarëve
Ku i kam fshehur librat e vjetër
Të ndaluar nga secili regjim
Që përdhoste tokën e shenjtë të Dardanisë

ADEM ZAPLLUZHA

SEPSE MË KA MBETUR NJË FRIKË

Kur hy në dhomën e punës
Me mua janë të gjitha zanoret
Nuk mungojnë as bashkëtingëlloret
Pentagrami mbi divanin e grisur
Përjeton zbritjen dhe ngritjen e notave

Sa herë që e theva çelësin e violinës
Si çafkat e zeza telat e kitarës
Ikën nga dhoma ime
Thua se kurrë nuk do dëgjohet
Kori imagjinar i bretkosave

Muzika e një lashtësie të padukshme
Fshihej mes sirtarëve
Ku i kam fshehur librat e vjetër
Të ndaluar nga secili regjim
Që përdhoste tokën e shenjtë të Dardanisë

60

Ja pra kur jam në dhomën time të punës
Bisedoj me sekretet e mia
Ende bisedoj
Sepse më ka mbetur një frikë
E cila më ndjek që nga adoleshenca

Prishtinë, 18 korrik 2018

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Ja pra kur jam në dhomën time të punës
Bisedoj me sekretet e mia
Ende bisedoj
Sepse më ka mbetur një frikë
E cila më ndjek që nga adoleshenca

Prishtinë, 18 korrik 2018

61

KËTU KEMI VARRE TË FRIKËSUARA

Ja këtu në anën e majtë të lumit
Si delet e murrme
Pushojnë varret
Mbase erdhën nga një rrugë e gjatë
Erdhën nga luftërat e huaja

Disa janë tejet krenarë
Për trimëritë e treguara
E disa të tjerë turpërohen
Sepse luftuan për të huaj
Dhe u vranë po ashtu nga të huajt

Këtu kemi varre të frikësuara
Dhe të turpëruara
Pa asnjë shënim nga kronisti i dehur
Varret pranë lumit
Mbase një ditë do t'i merr lumi

Këtu në anën e djathtë të lumit
Shtrihen varret e atyre
Që u varrosën me dykrenor të gdhendur
Luftëtarëve që u flijuan për tokën e etërve
Duke u shndërruan në përmendore

ADEM ZAPLLUZHA

KËTU KEMI VARRE TË FRIKËSUARA

Ja këtu në anën e majtë të lumit
Si delet e murrme
Pushojnë varret
Mbase erdhën nga një rrugë e gjatë
Erdhën nga luftërat e huaja

Disa janë tejet krenarë
Për trimëritë e treguara
E disa të tjerë turpërohen
Sepse luftuan për të huaj
Dhe u vranë po ashtu nga të huajt

Këtu kemi varre të frikësuara
Dhe të turpëruara
Pa asnjë shënim nga kronisti i dehur
Varret pranë lumit
Mbase një ditë do t'i merr lumi

Këtu në anën e djathtë të lumit
Shtrihen varret e atyre
Që u varrosën me dykrenor të gdhendur
Luftëtarëve që u flijuan për tokën e etërve
Duke u shndërruan në përmendore

62

PËR TË HUAJT DHE TOKËN E HUAJ

Nuk më beson askush
Por më shumë se nëntë ditë
Nuk munda të gjejë asnjë fjalë
Për të thurur një varg
Për kuajt e varrosur pranë lumit

Ja këtu diku as në anën e majtë
E as në anën e djathtë
Varrosëm kuaj dhe shalat e grisura
Dizgjinët ende qëndrojnë të varur
Nëpër degët e mështeknës

Ju thashë se këto varre të kuajve
Janë peng i një kohe
Histori e hidhur
Për djemtë e vdekur diku ledheve të historisë
Për të huajt dhe tokën e huaj

Gjithmonë befasohem
Kur në këtë vend pranë lumit
I dëgjoj hingëllimat e trishtuara të luftës
I dëgjoj edhe piskamat e djemve
Që vdisnin për mbretër dhe pashallarë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

PËR TË HUAJT DHE TOKËN E HUAJ

Nuk më beson askush
Por më shumë se nëntë ditë
Nuk munda të gjejë asnjë fjalë
Për të thurur një varg
Për kuajt e varrosur pranë lumit

Ja këtu diku as në anën e majtë
E as në anën e djathtë
Varrosëm kuaj dhe shalat e grisura
Dizgjinët ende qëndrojnë të varur
Nëpër degët e mështeknës

Ju thashë se këto varre të kuajve
Janë peng i një kohe
Histori e hidhur
Për djemtë e vdekur diku ledheve të historisë
Për të huajt dhe tokën e huaj

Gjithmonë befasohem
Kur në këtë vend pranë lumit
I dëgjoj hingëllimat e trishtuara të luftës
I dëgjoj edhe piskamat e djemve
Që vdisnin për mbretër dhe pashallarë

63

MBETA I VETËM NË KËTË VORBULL

Mbeta kalli i vetëm
Kur thashë vetëm
Askush nuk është pranë meje
Ndoshta nuk ishte as vetvetja ime
Andaj isha një kalli gruri në shkretëtirë

Me kërshëri i shikoj duart prej ashti
Mbase nuk më duken
Si të miat
Në dorën e djathtë mbajë një ushtë
Kurse në të majtën thikën e ndryshkur

Ja përse më ishin të panjohura
Më dukeshin si të huaja
Vrastare dhe delikate
Shikoj plepin e moshuar
Degët luhaten si kurmi im në hapësirë

Mbeta i vetëm në këtë vorbull
Të pashpirt të dynjasë
Unë vetmia ime dhe ushta
Me një thikë të topitur
E cila me egërsi ngulet në ashtin tim

ADEM ZAPLLUZHA

MBETA I VETËM NË KËTË VORBULL

Mbeta kalli i vetëm
Kur thashë vetëm
Askush nuk është pranë meje
Ndoshta nuk ishte as vetvetja ime
Andaj isha një kalli gruri në shkretëtirë

Me kërshëri i shikoj duart prej ashti
Mbase nuk më duken
Si të miat
Në dorën e djathtë mbajë një ushtë
Kurse në të majtën thikën e ndryshkur

Ja përse më ishin të panjohura
Më dukeshin si të huaja
Vrastare dhe delikate
Shikoj plepin e moshuar
Degët luhaten si kurmi im në hapësirë

Mbeta i vetëm në këtë vorbull
Të pashpirt të dynjasë
Unë vetmia ime dhe ushta
Me një thikë të topitur
E cila me egërsi ngulet në ashtin tim

64

PËR BALLOT SEKRETE TË MASKAVE

Nëpër mure afishe të ngjitura
Secila parti identifikohet
Me gënjeshtrën e vet
Nuk mungojnë as fotografitë
E qeshjeve alegorike
Të njerëzve dykrenor

Si hije qëndrojnë të kërthndezur
Qëndrojnë me një pamje largpamëse
Kurse në brendinë e tyre
Në mënyrë më sarkastike
Shtrihet mashtrimi
Në shtratin e gënjeshtrës së kulluar

Muret e ngjyera e të lyera
Si të rinjtë
Për ballot sekrete të maskave
Të ngrohta e të akullta
Nga qepallat si rrëshira u pikon fjala
Ec e besoju këtyre thashethemet

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

PËR BALLOT SEKRETE TË MASKAVE

Nëpër mure afishe të ngjitura
Secila parti identifikohet
Me gënjeshtrën e vet
Nuk mungojnë as fotografitë
E qeshjeve alegorike
Të njerëzve dykrenor

Si hije qëndrojnë të kërthndezur
Qëndrojnë me një pamje largpamëse
Kurse në brendinë e tyre
Në mënyrë më sarkastike
Shtrihet mashtrimi
Në shtratin e gënjeshtrës së kulluar

Muret e ngjyera e të lyera
Si të rinjtë
Për ballot sekrete të maskave
Të ngrohta e të akullta
Nga qepallat si rrëshira u pikon fjala
Ec e besoju këtyre thashethemet

65

TË KTHEHET DHËNDRI I KIDNAPUAR

Mbrëmë u larguan zogjtë e shirave
Ikën përtej shtatë bjeshkëve
E tetë maleve
Ikën pas vetëtimave zogjtë e shiut

Më pastaj ra një shtrezë e dyshimtë
Dogji edhe njomësinë e barit
Nuk kanë se ku të kullosin qengjat
Nga malet po dynden do re të zeza

Një nuse nëntëmbëdhjetë vjet me padurim
Pret në gjerdek
Të kthehet dhëndri i kidnapuar
Mbase të kota janë pritjet e saja

Edhe sivjet po frynë e nuk ndalen
Erërat e zeza
Disa shtëllungë mjegulle të plumbtë
Si gur varri na qëndrojnë mbi kokë

ADEM ZAPLLUZHA

TË KTHEHET DHËNDRI I KIDNAPUAR

Mbrëmë u larguan zogjtë e shirave
Ikën përtej shtatë bjeshkëve
E tetë maleve
Ikën pas vetëtimave zogjtë e shiut

Më pastaj ra një shtrezë e dyshimtë
Dogji edhe njomësinë e barit
Nuk kanë se ku të kullosin qengjat
Nga malet po dynden do re të zeza

Një nuse nëntëmbëdhjetë vjet me padurim
Pret në gjerdek
Të kthehet dhëndri i kidnapuar
Mbase të kota janë pritjet e saja

Edhe sivjet po frynë e nuk ndalen
Erërat e zeza
Disa shtëllungë mjegulle të plumbtë
Si gur varri na qëndrojnë mbi kokë

66

RRUGA ISHTE E GJATË SI FRIKA

I lashë të gjitha kujtimet
Pas një fjale
Në një ankand të çmendur
Që nga koha e adoleshencës
I shita për pak lek
Letrat e dashurisë

Mbeta fillikat vetëm
Në këtë botë sarkastike
Heshtja e fantazmagorisë
Ishte më e rënd se çdo dhembje
Të cilën mund ta duroj njeriu
Ishte një vigmë
Që i shembte muret e shpirtit

Eca edhe njëmijë vjet
Nëpër një monopat të trilluar
Më përcillnin gjarpinjtë
Dhe hienat e konvertuara në njerëz
Rruga ishte e gjatë si frika
Dhe e thellë
Sa që i shëmbëllente Ferrit të Dantes

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

RRUGA ISHTE E GJATË SI FRIKA

I lashë të gjitha kujtimet
Pas një fjale
Në një ankand të çmendur
Që nga koha e adoleshencës
I shita për pak lek
Letrat e dashurisë

Mbeta fillikat vetëm
Në këtë botë sarkastike
Heshtja e fantazmagorisë
Ishte më e rënd se çdo dhembje
Të cilën mund ta duroj njeriu
Ishte një vigmë
Që i shembte muret e shpirtit

Eca edhe njëmijë vjet
Nëpër një monopat të trilluar
Më përcillnin gjarpinjtë
Dhe hienat e konvertuara në njerëz
Rruga ishte e gjatë si frika
Dhe e thellë
Sa që i shëmbëllente Ferrit të Dantes

67

SHIKO SA BUKUR KËNDON GJELBËRIMI

Struku diku thellë
Në qenien e pluhurit
Struku dhe përgjo
Se si merr frymë gjelbërimi
Kur këndojnë gjinkallat
Para se të piqet rrushi

Kjo këngë dhe ky pluhur
Nuk janë prej ditëve të sotme
Njëmijë vjet nuk pushon kori
I bretkosave të verdha
Këndojnë më mirë se çdo kor mbretëror
Para abdikimit të mbretëreshës

Struku diku mes thellësisë
Dhe cekëtinës
Shiko se sa bukur këndon gjelbërimi
Në majat e selvive
Këndon derisa nuk paraqitet agullima
Me tërë forcën e saj shndritëse

ADEM ZAPLLUZHA

SHIKO SA BUKUR KËNDON GJELBËRIMI

Struku diku thellë
Në qenien e pluhurit
Struku dhe përgjo
Se si merr frymë gjelbërimi
Kur këndojnë gjinkallat
Para se të piqet rrushi

Kjo këngë dhe ky pluhur
Nuk janë prej ditëve të sotme
Njëmijë vjet nuk pushon kori
I bretkosave të verdha
Këndojnë më mirë se çdo kor mbretëror
Para abdikimit të mbretëreshës

Struku diku mes thellësisë
Dhe cekëtinës
Shiko se sa bukur këndon gjelbërimi
Në majat e selvive
Këndon derisa nuk paraqitet agullima
Me tërë forcën e saj shndritëse

68

KORI I QIELLIT ATË DITË

Mbi dyshemenë prej fieri
Qëndroja kacule
Qëndroja në gjunjë duke lexuar
Libra që nga koha e Homerit

Cirqet ishin krijesa të buta
Të dashura
Si sirenat e deteve të imagjinatave
Kaherë e dinin këngën haleluja

Më kujtohet kur një ditë binte brymë
Me bretkosa të verdha
Kori i qiellit atë ditë
Më duket se i shëmbëllente Parajsës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KORI I QIELLIT ATË DITË

Mbi dyshemenë prej fieri
Qëndroja kacule
Qëndroja në gjunjë duke lexuar
Libra që nga koha e Homerit

Cirqet ishin krijesa të buta
Të dashura
Si sirenat e deteve të imagjinatave
Kaherë e dinin këngën haleluja

Më kujtohet kur një ditë binte brymë
Me bretkosa të verdha
Kori i qiellit atë ditë
Më duket se i shëmbëllente Parajsës

69

TË MOS U BESOJNË LETRAVE

Ndoshta ishte koha e kthimeve
Në çastin kur ajo largohej atë ditë
Qielli dukej
Si një herbarium i venitur
Ose një hartë e zhubrosur
Ku nuk mund të lexohej asnjë shënim

Më duket se e kishin nxjerrë qiellin
Nga goja e kaut të zi
Aq ishte e përtypur ajo hartë e vjetër
Sa që asnjë shkronjë ose vend
Nuk mund të lexohej më
Në pergamenën e grisur

Që nga ajo ditë e kobshme
Njerëzit filluan
Të mos u besojnë letrave
Secili sipas qejfit të vetë
Ngulte nga një gur sherri nëpër sinorë
Që nga ajo kohë
Si uragan rriteshin grindjet mes njerëzve

ADEM ZAPLLUZHA

TË MOS U BESOJNË LETRAVE

Ndoshta ishte koha e kthimeve
Në çastin kur ajo largohej atë ditë
Qielli dukej
Si një herbarium i venitur
Ose një hartë e zhubrosur
Ku nuk mund të lexohej asnjë shënim

Më duket se e kishin nxjerrë qiellin
Nga goja e kaut të zi
Aq ishte e përtypur ajo hartë e vjetër
Sa që asnjë shkronjë ose vend
Nuk mund të lexohej më
Në pergamenën e grisur

Që nga ajo ditë e kobshme
Njerëzit filluan
Të mos u besojnë letrave
Secili sipas qejfit të vetë
Ngulte nga një gur sherri nëpër sinorë
Që nga ajo kohë
Si uragan rriteshin grindjet mes njerëzve

70

ME TRISHTIMET E MIA TË PËRDITSHME

Kur kthehem në atdhe
Nuk di
Se çfarë më duhet të ju sjelli
Fëmijërinë e harrova rrugëve
Nëpër metropole
Më mbetën kujtimet e adoleshencës

Çfarë mund të ju sjelli
Përpos dhembjes dhe halleve
Që m'i shqyenin si astarin e palltos së vjetër
M'i shqyenin mushkrit
Copë e grim
Mu bë gurmazi nga kolla e keqe

Nuk pata kohë ose më mirë me thënë
Nuk desha të ju sjelli dhembjet
Aq shumë më kanë dërmuar
Sa që nuk më mbeti fare forcë
T'i mbushi valixhet
Me trishtimet e mia të përditshme
Prishtinë,19 korrik 2018

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ME TRISHTIMET E MIA TË PËRDITSHME

Kur kthehem në atdhe
Nuk di
Se çfarë më duhet të ju sjelli
Fëmijërinë e harrova rrugëve
Nëpër metropole
Më mbetën kujtimet e adoleshencës

Çfarë mund të ju sjelli
Përpos dhembjes dhe halleve
Që m'i shqyenin si astarin e palltos së vjetër
M'i shqyenin mushkrit
Copë e grim
Mu bë gurmazi nga kolla e keqe

Nuk pata kohë ose më mirë me thënë
Nuk desha të ju sjelli dhembjet
Aq shumë më kanë dërmuar
Sa që nuk më mbeti fare forcë
T'i mbushi valixhet
Me trishtimet e mia të përditshme
Prishtinë,19 korrik 2018

71

ADEM ZAPLLUZHA

72

Cikli i tretë
Nga malet zbritën zërat e egra

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

Cikli i tretë
Nga malet zbritën zërat e egra

73

ADEM ZAPLLUZHA

74

BRENDA MEJE NJË GJENDJE ASNJANËSE

Përbrenda ose nga jashtë
Por gjithsesi
Një zë i trishtuar
Dëgjohet ose grafullon nga parzma e tokës

Dikush ishte këtu
Dhe i mbolli lulet e së keqes
Nga trishtimet e mjegullave
Dhe kurrë më nuk e pamë diellin

Nuk i pamë as zogjtë e shiut
Një borë e murrme pjalmonte
Nëpër degët e thyera të rrapeve
Pjalmonte dielli i leckosur nga vullkanet

Përbrenda meje një gjendje asnjanëse
Në pranverë ndjej acarin e kristaltë
Kurse në dimër
Më griset lëkura e zeshktë nga dielli

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

BRENDA MEJE NJË GJENDJE ASNJANËSE

Përbrenda ose nga jashtë
Por gjithsesi
Një zë i trishtuar
Dëgjohet ose grafullon nga parzma e tokës

Dikush ishte këtu
Dhe i mbolli lulet e së keqes
Nga trishtimet e mjegullave
Dhe kurrë më nuk e pamë diellin

Nuk i pamë as zogjtë e shiut
Një borë e murrme pjalmonte
Nëpër degët e thyera të rrapeve
Pjalmonte dielli i leckosur nga vullkanet

Përbrenda meje një gjendje asnjanëse
Në pranverë ndjej acarin e kristaltë
Kurse në dimër
Më griset lëkura e zeshktë nga dielli

75

FRYJ MOJ ERË

Fryj pa u ndalur
Në asnjë stacion
fryj moj erë
Le të më thahet
Kjo këmishë prej shiu
Më shumë se njëqind vjet
Nuk m'i ledhatove flokët e thinjura

Fryj e mos u ndalë
Në asnjë shtrojerë
Kemi nevojë
Sa shumë kemi nevojë
Për frymëmarrjen tënde
Fryj moj erë
Fryj nëpër rrugët e leckosura

ADEM ZAPLLUZHA

FRYJ MOJ ERË

Fryj pa u ndalur
Në asnjë stacion
fryj moj erë
Le të më thahet
Kjo këmishë prej shiu
Më shumë se njëqind vjet
Nuk m'i ledhatove flokët e thinjura

Fryj e mos u ndalë
Në asnjë shtrojerë
Kemi nevojë
Sa shumë kemi nevojë
Për frymëmarrjen tënde
Fryj moj erë
Fryj nëpër rrugët e leckosura

76

KANË SHLYER NJËHERË E PËRGJITHMONË

Gjithmonë në kokat tona
Na përzihen emrat e njerëzve
Dhe të gjërave të ndryshme
Na përzihet pasqyra me amalgamën
Dhe hija e korridorit
Ku vdesin mushkonjat nga lagështia

Kur bisedojmë për ngjyrën e luleve
Parasysh na dalin asociacionet
E ngjyrave të ylberit
Dhe luadhet ku ylberet i derdhin
Të gjitha ngjyrat e dynjasë
Mbi shpirtrat e koshareve të bletëve

Ka edhe të tillë në mesin tonë
Që nuk i harrojnë emrat e zogjve
Dhe të specieve shtëpiake
Nuk i harrojnë sepse nga truri i tyre
Kanë shlyer njëherë e përgjithmonë
Itinerarin njëdrejtimësh të harresës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KANË SHLYER NJËHERË E PËRGJITHMONË

Gjithmonë në kokat tona
Na përzihen emrat e njerëzve
Dhe të gjërave të ndryshme
Na përzihet pasqyra me amalgamën
Dhe hija e korridorit
Ku vdesin mushkonjat nga lagështia

Kur bisedojmë për ngjyrën e luleve
Parasysh na dalin asociacionet
E ngjyrave të ylberit
Dhe luadhet ku ylberet i derdhin
Të gjitha ngjyrat e dynjasë
Mbi shpirtrat e koshareve të bletëve

Ka edhe të tillë në mesin tonë
Që nuk i harrojnë emrat e zogjve
Dhe të specieve shtëpiake
Nuk i harrojnë sepse nga truri i tyre
Kanë shlyer njëherë e përgjithmonë
Itinerarin njëdrejtimësh të harresës

77

IMITON ME DISA GJESTE DELIKATE

Ngjanë që kur takohemi
Miqtë ndërmjet veti
Kam parë që secili
S'do me qenë vetvetja e vetë
Por imiton dikë tjetër

Imiton mbase turpërohet
Nga vetvetja
Tjetri i duket diçka më mirë
Se sa mund të jetë uni i tij
Kështu që duke imituar
Nuk i ngjan askujt e as vetvetes

Imiton me disa gjeste delikate
Të majmunëve në degë
Dhe me një kollare prej letre
Paraqitet si një kloun
Në aktin e tretë të mbrëmjes
Të gjithë e përqeshin njëri - tjetrin

ADEM ZAPLLUZHA

IMITON ME DISA GJESTE DELIKATE

Ngjanë që kur takohemi
Miqtë ndërmjet veti
Kam parë që secili
S'do me qenë vetvetja e vetë
Por imiton dikë tjetër

Imiton mbase turpërohet
Nga vetvetja
Tjetri i duket diçka më mirë
Se sa mund të jetë uni i tij
Kështu që duke imituar
Nuk i ngjan askujt e as vetvetes

Imiton me disa gjeste delikate
Të majmunëve në degë
Dhe me një kollare prej letre
Paraqitet si një kloun
Në aktin e tretë të mbrëmjes
Të gjithë e përqeshin njëri - tjetrin

78

KUR GJETHET SHKËRMOQEN

Nuk mund të na ndaj
Aq më pak
Të na fundosi kjo heshtje
Lulet rriten edhe pa i prekur rrënjët
Kur gjethet shkërmoqen
Si dhëmbët e thyera të kohës

Të kam thënë se heshtja është vrastare
I vret fluturat e kaltra të mendimeve
Ti mos i ngacmo kujtimet
As të kaluarën
Për fajin tim
Çfarë faji mund të kenë etërit e mi

Ti nuk më besove asnjëherë
Ndoshta as nuk deshe të më besosh
Se as toka e as dielli
Nuk rrotullohen përse duam ne
Këto lëvizje alegorike
Imitojnë itineraret e pafundme të yjeve

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KUR GJETHET SHKËRMOQEN

Nuk mund të na ndaj
Aq më pak
Të na fundosi kjo heshtje
Lulet rriten edhe pa i prekur rrënjët
Kur gjethet shkërmoqen
Si dhëmbët e thyera të kohës

Të kam thënë se heshtja është vrastare
I vret fluturat e kaltra të mendimeve
Ti mos i ngacmo kujtimet
As të kaluarën
Për fajin tim
Çfarë faji mund të kenë etërit e mi

Ti nuk më besove asnjëherë
Ndoshta as nuk deshe të më besosh
Se as toka e as dielli
Nuk rrotullohen përse duam ne
Këto lëvizje alegorike
Imitojnë itineraret e pafundme të yjeve

79

DISA LLOJE SHTAMBASH PREJ ARGJILE

Unë nuk di përse pres
E çfarë jam duke pritur
Këndej më nuk kalojnë trenat
Ikën bashkë me ty
Të gjitha kujtimet që desha t'i harroj
U fshehën si të padëshiruara
Pas akrepave të orës së murit

Të thashë se trenat nuk kalojnë
Nëpër binarë
Ku janë kalbur ose mungojnë traversat
Këto llagëme ku s'çelin lulet
I varrosëm fjalët dhe fjalosjet tona
Tani më si një dhembje
Na ka mbetur vetëm këmisha e grindjes

Nesër do të thonë njerëzit
Do të thonë siç pohojnë gjithmonë
Se nëpër këtë fushë mëllenjash
Asnjëherë nuk fluturuan fluturat
Por sërish do shohim vasha
Syjeshile duke bartur në duar
Disa lloje shtambash prej argjile

ADEM ZAPLLUZHA

DISA LLOJE SHTAMBASH PREJ ARGJILE

Unë nuk di përse pres
E çfarë jam duke pritur
Këndej më nuk kalojnë trenat
Ikën bashkë me ty
Të gjitha kujtimet që desha t'i harroj
U fshehën si të padëshiruara
Pas akrepave të orës së murit

Të thashë se trenat nuk kalojnë
Nëpër binarë
Ku janë kalbur ose mungojnë traversat
Këto llagëme ku s'çelin lulet
I varrosëm fjalët dhe fjalosjet tona
Tani më si një dhembje
Na ka mbetur vetëm këmisha e grindjes

Nesër do të thonë njerëzit
Do të thonë siç pohojnë gjithmonë
Se nëpër këtë fushë mëllenjash
Asnjëherë nuk fluturuan fluturat
Por sërish do shohim vasha
Syjeshile duke bartur në duar
Disa lloje shtambash prej argjile

80

SECILI PARAQITEJ MË I MIRË SE KRISHTI

Desha të shoh shumë gjëra
Pasionin tim mashkullor
Të pa shfrenuar dhe ty
Mes petaleve të trëndafilit
Por ja që asgjë nuk pashë
Ndoshta isha i verbër nga egoizmi

Sa herë që doja të shoh
Dhe t'i kuptoj gjërat
Ashtu siç kisha dëshirë vetëm unë
Më dilnin parasysh si statuja të lashta
Kalorësit dardanë
Më dilnin parasysh vashat syulliri

Lufta veç kishte përfunduar
Nëpër arenat e kujtimeve
Më dilnin parasysh dezertorët vrastarë
Më dilnin në zhgjëndërr
Me nga një lule në dorë
Secili paraqitej më i mirë se Krishti

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

SECILI PARAQITEJ MË I MIRË SE KRISHTI

Desha të shoh shumë gjëra
Pasionin tim mashkullor
Të pa shfrenuar dhe ty
Mes petaleve të trëndafilit
Por ja që asgjë nuk pashë
Ndoshta isha i verbër nga egoizmi

Sa herë që doja të shoh
Dhe t'i kuptoj gjërat
Ashtu siç kisha dëshirë vetëm unë
Më dilnin parasysh si statuja të lashta
Kalorësit dardanë
Më dilnin parasysh vashat syulliri

Lufta veç kishte përfunduar
Nëpër arenat e kujtimeve
Më dilnin parasysh dezertorët vrastarë
Më dilnin në zhgjëndërr
Me nga një lule në dorë
Secili paraqitej më i mirë se Krishti

81

KY DIELL I AKULLT HOMERIAN

Si një muzikë e lashtë
Dëgjohen fjalët e zogjve të shiut
Ndjejë se si ma shpojnë më gjilpërë
Timpanin e veshit të shurdhuar
Ndjejë një dhembje të madhe në tëmtha

Askush pranë meje
Aq shumë kisha nevojë për njerëz
Sa që fillova të ulërijë si ujkonja e Romës
Si një bishë e tërbuar
Kisha shumë nevojë për njerëz

Dielli veç e kishte shaluar
Atin e egër të mjegullave
Nga pikëllimet e rrufeve derdheshin
Si rrëke derdheshin
Llavat e rrezeve të përskuqura

Ky diell i akullt Homerian
Sa shumë rrezite e aspak
Nuk na i ngrohte shpirtrat
Më duket se ishte diell i legjendave të vjetra
Shndrite e nuk na i ngrohte eshtrat

ADEM ZAPLLUZHA

KY DIELL I AKULLT HOMERIAN

Si një muzikë e lashtë
Dëgjohen fjalët e zogjve të shiut
Ndjejë se si ma shpojnë më gjilpërë
Timpanin e veshit të shurdhuar
Ndjejë një dhembje të madhe në tëmtha

Askush pranë meje
Aq shumë kisha nevojë për njerëz
Sa që fillova të ulërijë si ujkonja e Romës
Si një bishë e tërbuar
Kisha shumë nevojë për njerëz

Dielli veç e kishte shaluar
Atin e egër të mjegullave
Nga pikëllimet e rrufeve derdheshin
Si rrëke derdheshin
Llavat e rrezeve të përskuqura

Ky diell i akullt Homerian
Sa shumë rrezite e aspak
Nuk na i ngrohte shpirtrat
Më duket se ishte diell i legjendave të vjetra
Shndrite e nuk na i ngrohte eshtrat

82

MOS HARRO TË LUTEM

Meqenëse po na ngufat varfëria
Na sill pak bukë
E ca kokrra ulliri të pjekur
Dua ta shoh diellin mes gjetheve
Dhe lumin e fshatit siç gurgullonte dikur
Në ëndrrat tona të ndaluara

Të lutem nëse mund të na dërgosh
Me postë elektronike
Barnat e mia të diabetit
Dërgo sa më parë me ndonjë shtërg
Po që se nuk dërgon
Mjekët do ma presin këmbën e majtë

Na ka pllakosur skamje e keqe
Kafenë dhe sheqerin e rruaj
Për miqtë e rrallë
Nuk dua që të na turpërohet vatra
E di ti se për mysafirë
Gjithmonë e kemi fshehur më të mirën

Mos harro të lutem
Na dërgo edhe një pako me letra tualeti
Dimrat i kemi të acarta
Po ngrihen gypat as për ilaç s’po kemi ujë

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

MOS HARRO TË LUTEM

Meqenëse po na ngufat varfëria
Na sill pak bukë
E ca kokrra ulliri të pjekur
Dua ta shoh diellin mes gjetheve
Dhe lumin e fshatit siç gurgullonte dikur
Në ëndrrat tona të ndaluara

Të lutem nëse mund të na dërgosh
Me postë elektronike
Barnat e mia të diabetit
Dërgo sa më parë me ndonjë shtërg
Po që se nuk dërgon
Mjekët do ma presin këmbën e majtë

Na ka pllakosur skamje e keqe
Kafenë dhe sheqerin e rruaj
Për miqtë e rrallë
Nuk dua që të na turpërohet vatra
E di ti se për mysafirë
Gjithmonë e kemi fshehur më të mirën

Mos harro të lutem
Na dërgo edhe një pako me letra tualeti
Dimrat i kemi të acarta
Po ngrihen gypat as për ilaç s’po kemi ujë

83

NË GJUHËN E METALT TË NJERIUT

Tani më kujtohet
Që shumë vonë kuptuam
Se në cilën anë të qytetit flinte dhembja
Flinte edhe kali i drurit
Në gjuhën e metaltë të njeriut
Flinte e keqja
E cila kurrë nuk kishte të sosur

Atë vit të brishtë
Nuk dëgjuam asnjë kambanë në qytet
Varret qanin si kërthi
Një lot prej shiu nuk ndalej
Duke i kalbur degët e bagremëve
Nëpër luadhe të kositura
Nuk doli bari për herë të dytë

Ishte fundi i verës delet e bardha
Si varret dukeshin luadheve të pakositura
Ne nuk e pritnim stinën e dëborës
Por ajo ia behu
Si çdo herë që vinte pa u lajmëruar
Dhe na zuri pisk
Asnjë kërcu s’na qëlloi t’i ngrohim eshtrat

ADEM ZAPLLUZHA

NË GJUHËN E METALT TË NJERIUT

Tani më kujtohet
Që shumë vonë kuptuam
Se në cilën anë të qytetit flinte dhembja
Flinte edhe kali i drurit
Në gjuhën e metaltë të njeriut
Flinte e keqja
E cila kurrë nuk kishte të sosur

Atë vit të brishtë
Nuk dëgjuam asnjë kambanë në qytet
Varret qanin si kërthi
Një lot prej shiu nuk ndalej
Duke i kalbur degët e bagremëve
Nëpër luadhe të kositura
Nuk doli bari për herë të dytë

Ishte fundi i verës delet e bardha
Si varret dukeshin luadheve të pakositura
Ne nuk e pritnim stinën e dëborës
Por ajo ia behu
Si çdo herë që vinte pa u lajmëruar
Dhe na zuri pisk
Asnjë kërcu s’na qëlloi t’i ngrohim eshtrat

84

KORBI

Një erë e fortë sokëllinë
Dimri i pamëshirshëm nëpër rrugë pjalmon
Acari hejet e thyera
Në drejtim të bjeshkës i pështynë
E baresha e pafat një elegji këndon

Këngë e lashtë dëgjohet në shtrojerë
Për një dashuri të pa përjetuar
Me mallëngjim qanë një korb i zi
Sytë e tij mbetën në gur
Ulur mbi kërcu vajton një shtërg i bardhë

Edhe një bareshë në bjeshkën përballë
Duke pritur dhëndrin
Flokë e vetulla shkuli
Mbase kjo legjendë u bë një përrallë
Si kuçedër rrufeve atë ditë iu vërsul

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

KORBI

Një erë e fortë sokëllinë
Dimri i pamëshirshëm nëpër rrugë pjalmon
Acari hejet e thyera
Në drejtim të bjeshkës i pështynë
E baresha e pafat një elegji këndon

Këngë e lashtë dëgjohet në shtrojerë
Për një dashuri të pa përjetuar
Me mallëngjim qanë një korb i zi
Sytë e tij mbetën në gur
Ulur mbi kërcu vajton një shtërg i bardhë

Edhe një bareshë në bjeshkën përballë
Duke pritur dhëndrin
Flokë e vetulla shkuli
Mbase kjo legjendë u bë një përrallë
Si kuçedër rrufeve atë ditë iu vërsul

85

KURMI YT I ZI NJË DITË

Mos ma prek kurmin
Edhe te ty
Një ditë vdekja vjen
Shikoje shpirtin tënd të lig
Shikoje
Se si një tradhti po zien

Këto mështekna të zeza
Dhe shelgje të pikëlluara
Asnjëherë nuk ishin këtu
Një erë e keqe
Solli farën
Dhe tani pa qejfin tënd
Janë ngulur në tokë si hunj

Kam pakëz të ftohtë
E më shumë frikë
Nga xhelozia
Humba shpirt zemër
Dhe prikë
Mos u hamendëso miku im
Kurmi yt i zi një ditë
Do të jetë për korba ushqim

ADEM ZAPLLUZHA

KURMI YT I ZI NJË DITË

Mos ma prek kurmin
Edhe te ty
Një ditë vdekja vjen
Shikoje shpirtin tënd të lig
Shikoje
Se si një tradhti po zien

Këto mështekna të zeza
Dhe shelgje të pikëlluara
Asnjëherë nuk ishin këtu
Një erë e keqe
Solli farën
Dhe tani pa qejfin tënd
Janë ngulur në tokë si hunj

Kam pakëz të ftohtë
E më shumë frikë
Nga xhelozia
Humba shpirt zemër
Dhe prikë
Mos u hamendëso miku im
Kurmi yt i zi një ditë
Do të jetë për korba ushqim

86

SI NJË AKROBAT I PËRSOSUR

Është natë
Koncerti i yjeve veç ka filluar
Një grusht re mbi mjegulla
Shtrydh lotin e hënës nga qumështi
Shtrydhë kujtimin e mështeknës

Dy pula të zeza mbi degët e kujtesës
I lëshuan vezët
Që u shëmbëllenin bombave prej hidrogjeni
Lëshuan dhe ikën
Pas një sterre të panjohur

Kjo natë nuk qenka si netët e tjera
Në pasionin e saj të egër femëror
Paska një trishtim
Sa herë që i tund shpatullat
Nga flokët shkunden fijet e këputura

Më duket nuk e kuptojmë imagjinatën e saj
Ajo ëndërronte thimthat e mushkonjave
Orë e çast nëpër telat e errësirës
Si një akrobat i përsosur
Ecte deri në vdekje mbi litarin e shpresës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

SI NJË AKROBAT I PËRSOSUR

Është natë
Koncerti i yjeve veç ka filluar
Një grusht re mbi mjegulla
Shtrydh lotin e hënës nga qumështi
Shtrydhë kujtimin e mështeknës

Dy pula të zeza mbi degët e kujtesës
I lëshuan vezët
Që u shëmbëllenin bombave prej hidrogjeni
Lëshuan dhe ikën
Pas një sterre të panjohur

Kjo natë nuk qenka si netët e tjera
Në pasionin e saj të egër femëror
Paska një trishtim
Sa herë që i tund shpatullat
Nga flokët shkunden fijet e këputura

Më duket nuk e kuptojmë imagjinatën e saj
Ajo ëndërronte thimthat e mushkonjave
Orë e çast nëpër telat e errësirës
Si një akrobat i përsosur
Ecte deri në vdekje mbi litarin e shpresës

87

DESHËN TË MREKULLOHEN

Ky shekull mbase qenka
Shekulli i statujave
Fqinjët e shtetit tim në çdo hap
Mbjellin statuja antike
Mbase donë të identifikohen
Me të kaluarën e tyre
E cila asnjëherë nuk ka ekzistuar

Në qendër të qytetit
Prej mermeri të kuq
Ose betoni ngjyrë hiri mbollën
Disa lloje përmendoresh të huaja
Duke u dhënë shpirt kuajve
Deshën të identifikohen
Mbase me të kaluarën e të tjerëve

Edhe për Nënën Terezë
Ngritën një përmendore madhështore
Duke u mrekulluar
Me mrekullitë e saja
Komshinjtë e mi me tërë sarkazëm
Paskan vendosur për sivjet
Të ngrehin një përmendore njeriut të akullt

ADEM ZAPLLUZHA

DESHËN TË MREKULLOHEN

Ky shekull mbase qenka
Shekulli i statujave
Fqinjët e shtetit tim në çdo hap
Mbjellin statuja antike
Mbase donë të identifikohen
Me të kaluarën e tyre
E cila asnjëherë nuk ka ekzistuar

Në qendër të qytetit
Prej mermeri të kuq
Ose betoni ngjyrë hiri mbollën
Disa lloje përmendoresh të huaja
Duke u dhënë shpirt kuajve
Deshën të identifikohen
Mbase me të kaluarën e të tjerëve

Edhe për Nënën Terezë
Ngritën një përmendore madhështore
Duke u mrekulluar
Me mrekullitë e saja
Komshinjtë e mi me tërë sarkazëm
Paskan vendosur për sivjet
Të ngrehin një përmendore njeriut të akullt

88

ÇFARË TË BËJ ME ITINERARET

Më kanë lodhur e dërmuar
Udhëtimet e gjata
Çfarë të bëj me itineraret
Që nuk përfundojnë asnjëherë
Kam mbetur pa asnjë adresë

Mikun që e takova gjatë pushimeve
Kishte përfunduar në një aksident
Komunikacioni
Vetëm disa fotografi kanë mbetur
Nëpër celulare

Më telefonuan fëmijët e tij
Bisedonin në një gjuhë të huaj për mua
Biseduam shumë gjatë
Pa ditur se çfarë po bisedojmë
Në adresën elektronike dërguan fotografitë

Më duket se imazhet ishin nga një tavernë
Kur rrufisnin birrë të akullt Peje
I vetmi kujtim që na kishte mbetur
Nga Alpet Shqiptare
Diku në grykat e thella të Tropojës

KUR KTHEHEN ZOGJTË E SHIHUT

ÇFARË TË BËJ ME ITINERARET

Më kanë lodhur e dërmuar
Udhëtimet e gjata
Çfarë të bëj me itineraret
Që nuk përfundojnë asnjëherë
Kam mbetur pa asnjë adresë

Mikun që e takova gjatë pushimeve
Kishte përfunduar në një aksident
Komunikacioni
Vetëm disa fotografi kanë mbetur
Nëpër celulare

Më telefonuan fëmijët e tij
Bisedonin në një gjuhë të huaj për mua
Biseduam shumë gjatë
Pa ditur se çfarë po bisedojmë
Në adresën elektronike dërguan fotografitë

Më duket se imazhet ishin nga një tavernë
Kur rrufisnin birrë të akullt Peje
I vetmi kujtim që na kishte mbetur
Nga Alpet Shqiptare
Diku në grykat e thella të Tropojës

89

SI VARRI I KATRAGJYSHIT TIM

Fjala ime
Pengu i shpirtit tim
Trëndafili me dhe pa gjemba
Sa shumë i shëmbëllen
Gjuhës së etërve të mi

Ishte koha kur përjetova
Lindjen
Dhe vdekjen e kryqit tim
Në shtatë kroje shuante etjen e gjuhës
Zambaku i bardhë i Prizrenit

Më kujtohet kur nëntë herë u linda
Dhe po aq herë vdiqa për fjalën time
Më pastaj sërish më mbeti peng fjala
Si varri i katragjyshit
Shënuar mbi një rrasë të murrmë

ADEM ZAPLLUZHA

SI VARRI I KATRAGJYSHIT TIM

Fjala ime
Pengu i shpirtit tim
Trëndafili me dhe pa gjemba
Sa shumë i shëmbëllen
Gjuhës së etërve të mi

Ishte koha kur përjetova
Lindjen
Dhe vdekjen e kryqit tim
Në shtatë kroje shuante etjen e gjuhës
Zambaku i bardhë i Prizrenit

Më kujtohet kur nëntë herë u linda
Dhe po aq herë vdiqa për fjalën time
Më pastaj sërish më mbeti peng fjala
Si varri i katragjyshit
